

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5641  
E premte, 30 nëntor 2019  
çmimi 0.40 €

## MASHT-i ndalon përdorimin e telefonit gjatë procesit mësimor



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)




facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

#### SHKËMBIMI I TERRITOREVE

F. 12



Rexhep QOSJA

#### SISTEMI INFORMATIV I TREGUT TË PUNËS, NË DISPOZICION TË QYTETARËVE

F. 6

#### KLINIKA E NEUROKIRURGJISË IA HEQ PACIENTES TUMORIN QË IA KISHTE VERBUAR SYRIN

F. 6

### EKONOMI

#### MINISTRI SHALA U BËNË THIRRJE QYTETARËVE T'I KONSUMOJNË PRODUKTET VENDORE

F. 9

#### XHEVDET TAHIRI EMËROHET USHTRUES DETYRE I DREJTORIT TË 'TREPÇËS'

F. 9

### KULTURË

#### PËRMASAT E FILMIT 'SKËNDERBEU'

F. 13



Shkruan: Jakup KRASNIQI

### SPORT

#### ISLAMI: FERONIKELI SYNON DALJEN NË EVROPË

F. 16

#### 'EPOKA E RE' PËR FITORE EDHE NDAJ 'KOSOVAPRESS'-it

F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", ADEM GRABOVCI

## BE-ja t'i bëjë presion Serbisë, jo Kosovës

- Dorëheqjet e kryetarëve të komunave në veri të Kosovës janë bërë në koordinim me Beogradin zyrtar



Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Adem Grabovci, e ka quajtur të vonuar dhe të paanalizuar mirë vendimin e Qeverisë për vendosjen e taksës prej 100 përqindësh për produktet me origjinë nga Serbia. Pavarësisht prej kësaj, ai i ka dhënë mbështetje këtij vendimi.

Grabovci ka thënë se për shkak të fushatës së egër të Serbisë karshi Kosovës ndaj shtetit serb do të duhej të ketë reciprocitet të plotë në të gjitha fushat. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Grabovci i ka vlerësuar të padrejta reagimet e zyrtarëve të BE-së karshi këtij vendimi. Ai

ka theksuar se BE-ja duhet të reagojë ndaj qasjes destruktive dhe armiqësore të Serbisë ndaj Kosovës dhe jo ndaj veprimeve mbrojtëse të shtetit tonë. Ndërsa sa i përket vendimit të dorëheqjes së kryetarëve të komunave në veri, Grabovci ka thënë se ky vendim ka qenë i nxitur nga Beogradi zyrtar

## Parlamenti Evropian bën thirrje për liberalizimin e vizave për Kosovën

FAQE 3

Parlamenti Evropian ka miratuar të enjten Raportin e Progresit për Kosovën nëpërmjet të cilit i kërkohet Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian që t'i liberalizojë vizat për qytetarët e Kosovës. Në këtë raport është theksuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet e kërkuara për heqjen e regjimit të vizave. Nëpërmjet këtij raporti, që vlerëson të arriturat dhe ngeçjet e institucioneve të Kosovës, është kërkuar depolitizimi dhe ristrukturimi i admin-



istratës publike. Por, shqetësuese, sipas eurodeputetëve, mbesin korrupsioni dhe krimi i organizuar



## Thaçi në ShBA merr mbështetjen për transformimin e FSK-së

FAQE 2

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Bushati viziton Plavën dhe Gucinë

TIRANË, 29 NËNTOR - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, nis të enjten një viz-

itë në komunat Plavë dhe Guci, në Malin e Zi. Në njohim për shtyp të MEPJ-së bëhet me dije se ministri

Bushati do të takohet me shqiptarët e Malit të Zi për t'i uruar për festat e nëntorit. Bushati do të takohet me

kryetarët e forcave politike që përfaqësojnë shqiptarët dhe të zgjedhurit e tyre në Këshillin Bashkiak të Plavës

dhe Gucisë dhe do t'i inaugurojë ambientet e reja të Këshillit Kombëtar të Shqipërisë.

# Thaçi në ShBA merr mbështetjen për transformimin e FSK-së

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në takim me senatorin republikan Marco Rubio dhe senatoren Joni Ernst, ka marrë mbështetje të plotë për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe dialogun me Serbinë



PRISHTINË, 29 NËNTOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të enjten është takuar me senatorin republikan Marco Rubio, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin në mes të Kosovës dhe ShBA-së, për transformimin e FSK-së dhe dialogun me Serbinë. "Edhe me senatorin republikan, Marco Rubio, biseduam për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit bilateral, për transformimin e FSK-së, perspektivën euroatlantike të Kosovës, si dhe për shfrytëzimin e momentumit për arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila siguron anëtarësimin e Kosovës në NATO, BE dhe OKB. Në të gjitha këto çështje Kosova ka mbështetjen e plotë të republikanëve dhe të demokratëve", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në kuadër të vizitës zyrtare në Amerikë, është takuar edhe me senatoren Joni Ernst, me të cilin ka diskutuar për transformimin e Forcës së Sigurisë dhe për domosdoshmërinë e arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës

dhe Serbisë. "Me senatoren Joni Ernst, miken time dhe të Kosovës, biseduam për bashkëpunimin dypalësh, për transformimin e Forcës së Sigurisë dhe për domosdoshmërinë e arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Senatorja Joni Ernst është nga shteti i Iowas dhe bashkëpunimi ndërmjet shteteve tona e dëshmon më së miri lidhjen e fortë mes dy popujve tanë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërkaq senatorja Joni Ernst, tha se është shumë e rëndësishme që Kosova dhe Serbia të arrijnë një marrëveshje. "Ne duam paqe, duam stabilitet mes qeverive dhe presidenti Thaçi po punon me intensitet për këtë. Kështu që natyrisht unë e mbështes atë nismë", tha ajo.

Senatorja e vuri theksin te lidhjet e forta mes Aiovas dhe Kosovës dhe tha se shteti i saj do që të ketë paqe dhe mirëqenie për gjithë popullin e Kosovës. Presidenti Hashim Thaçi në kuadër të vizitës në ShBA ka takuar edhe kongresistin amerikan, Eliot Engel.

Thaçi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se mbështetja e kongresistit dhe e ShBA-së për Kosovën ka qenë, është dhe do të mbetet përherë jetike për popullin dhe vendin tonë. "Gjithmonë kënaqësi të takoj mikun e madh të Kosovës, kon-

gresistin amerikan, Eliot Engel. Kongresisti Engel në tri dekadat e fundit e ka përkrahur vazhdimisht vendin tonë në jetësimin e aspiratës për liri, pavarësi dhe shtetndërtim. Mbështetja e tij dhe e ShBA-së për Kosovën ka qenë, është dhe do të mbetet përherë jetike për


popullin dhe vendin tonë", ka shkruar Thaçi. Në fillim të kësaj vizite, presidenti Thaçi është takuar edhe me Sekretarin e Shtetit, Mike Pompeo, si dhe me John Bolton, këshilltar për Siguri Kombëtare i presidentit të ShBA-së, Donald Trump.

## Parlamenti Evropian voton pro integritet të Shqipërisë në BE

TIRANË, 29 NËNTOR - Parlamenti Evropian ka votuar pro raportit për integritetin e Shqipërisë në BE. Lajmi është bërë i ditur nga kreu i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla. Përmes një postimi në "Twitter", Balla tha se raporti në fjalë është hartuar nga eurodeputeti Kunt Fleckenstein. Mësohet se PE-ja i ka dhënë mbështetje rekomandimit për çeljen e negociatave për në BE. "Parlamenti Evropian ka votuar me 459 vota pro në favor të raportit të vitit 2018 për Shqipërinë. Ky raport mbështet

plotësisht rekomandimet e Komisionit Evropian që lejon hapjen e negociatave në njohje të përpjekjeve për zbatimin e reformave të bëra nga Shqipëria", ka shkruar Balla në rrjetin social.

Ndërkaq në rezolutën e miratuar për Shqipërinë, Parlamenti Evropian bën thirrje për dialog politik mes palëve dhe kthimin e opozitës në Parlament. "PE-ja inkurajon të gjitha forcat politike që të bëjnë përpjekje të mëtejshme për të krijuar një dialog të mirëfilltë politik dhe për të arritur bashkëpunim



konstruktiv, duke mbështetur kështu procesin e reformave; rithekson besimin e tij të fortë se dialogu politik duhet të zhvillohet brenda institucioneve demokratike; është shumë i shqetësuar për bojkotin de facto të procesit parlamentar nga opozita pas pushimit veror

të vitit 2018", shprehet Parlamenti Evropian.

Një vëmendje të veçantë rezoluta ia kushton reformës zgjedhore, duke inkurajuar punën e bërë deri më tani nga komisioni "ad hoc". "PE-ja kërkon adresimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR; nënvizon se nevojitet një reformë gjithëpërfshirëse dhe në kohë, me qëllim rritjen e besimit të publikut në procesin zgjedhor; kujton nevojën për t'u kushtuar vëmendje të duhur pretendimeve për financim të paligjshëm dhe të padeklaruar

të partive politike; mirëpret punën e Komitetit "ad-hoc" për reformën zgjedhore lidhur me pavarësinë dhe depolitizimin e administratës zgjedhore, transparencën në financimin e fushatës, regjistrimin e votuesve, blerjen e votave, përdorimin e teknologjive të reja të votimit dhe votimin jashtë vendit dhe i kërkon Parlamentit të Shqipërisë që të arrijë konsensus dhe të miratojë reformat e nevojshme në kohën e duhur para zgjedhjeve vendore të vitit 2019", thuhet në rezolutën e PE-së.

# Parlamenti Evropian bën thirrje për liberalizimin e vizave për Kosovën

Parlamenti Evropian ka miratuar të enjten Raportin e Progresit për Kosovën nëpërmjet të cilit i kërkohet Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian që t'i liberalizojë vizat për qytetarët e Kosovës. Në këtë raport është theksuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet e kërkuara për heqjen e regjimit të vizave. Nëpërmjet këtij raporti, që vlerëson të arriturat dhe ngecjet e institucioneve të Kosovës, është kërkuar depolitizimi dhe ristrukturimi i administratës publike. Por, shqetësuese, sipas eurodeputetëve, mbesin korrupsioni dhe krimi i organizuar


**EPOKA  
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Me 393 vota për, 139 kundër dhe 71 abstenime Parlamenti Evropian (PE) të enjten ka aprovuar Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2018. Nëpërmjet këtij raporti të përgatitur nga raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, Igor Sholtes, është kërkuar nga Këshilli i Ministrave të Bashkimit Evropian liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës. Sipas eurodeputetëve, është jetësore që kosovarëve t'u mundësohet udhëtimi pa viza, meqë kjo do ta përmirësojë stabilitetin dhe do ta sjellë Kosovën më afër Bashkimit Evropian. Pas miratimit të raportit, Sholtesi i ka falënderuar deputetët evropianë për mbështetjen e dhënë. "Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë deputetët e Parlamentit Evropian që dhanë mbështetjen e tyre për Raportin e Progresit të Parlamentit Evropian për

Kosovën për vitin 2018", ka shkruar ai në llogarinë e vet në "Twitter". Ndërsa komisionari për zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, ka bërë me dije se qëndrojnë prapa vlerësimit se Kosova ka përmbushur kriteret për heqjen e vizave. "Qëndrojmë mbrapa vlerësimit që Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave", ka thënë Hahn.

Kurse në emër të Këshillit të Bashkimit Evropian, sekretarja e shtetit të Austrisë, Karoline Edtstadler, ka thënë se ky këshill është duke shqyrtuar propozimin për liberalizimin e vizave. Pavarësisht prej kësaj, ajo ka thënë se nuk kanë ndonjë afat para tyre në lidhje me vendimin për vizat. Sidoqoftë, ajo ka theksuar se përgjegjësia është mbi Kosovën që t'i vazhdojë reformat.

Në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2018 flitet për përparimin dhe ngecjet që institucionet e Kosovës i kanë bërë drejt progresit të agjendës evropiane. Përmes këtij raporti,



është theksuar nevoja e depolitizimit dhe ristrukturimit të administratës publike, edhe pse janë bërë disa përparime në këtë drejtim. Megjithatë, shqetësuese, sipas eurodeputetëve, mbesin korrupsioni dhe krimi i organizuar, fusha këto në të cilat ata kanë kërkuar përpjekje të përbashkëta për përmirësimin e situatës në këtë drejtim. Po në këtë raport një theks i veçantë i është vënë çështjes së funksionimit të Kuvendit të Kosovës.

Kurse sa i përket drejtësisë, Parlamenti Evropian ka shprehur brengosjen rreth financimit të sektorit të gjyqësorit dhe korrupsionit me elemente të kapjes së shtetit, mungesës së gjykimeve të drejta, duke përfshirë edhe rastet e ekstradimit.

"Financimi jo i duhur i sistemit gjyqësor, korrupsioni i përhapur, elementet e kapjes së shtetit, ndikimet politike në sistemin e drejtësisë janë shqetësuese", është theksuar më tutje në raport.

Parlamenti Evropian ka inkurajuar vazhdimin e procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kurse sa i përket debatit për korrigjimin e kufijve, Parlamenti Evropian ka nënvizuar natyrën shumetnike të Kosovës dhe Serbisë, duke theksuar se shtetet etnikisht homogjene nuk duhet të jenë objektivi i rajonit. "Përkrahim dialogun si një kornizë për arritjen e një marrëveshjeje të përgjithshme për normalizim të marrëdhënieve në mes të Serbisë dhe Kosovës. Secila mar-

rëveshje mund të jetë e pranueshme nëse është në pajtueshmëri mes dy palëve, duke marrë parasysh stabilitetin e përgjithshëm të rajonit dhe ligjin ndërkombëtar", është theksuar në raport. Gjithashtu, Parlamenti Evropian ka kërkuar nga palët t'i zbatojnë marrëveshjet e nënshkruara, duke përfshirë këtu marrëveshjen për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, atë për hapjen e urës në Mitrovicë, marrëveshjen për menaxhimin e integruar të kufijve dhe marrëveshjen për energjinë. Po ashtu, Parlamenti Evropian ka kërkuar nga Federica Mogherini që të bëjë një vlerësim të zbatimit të deritashëm të marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi.

## Kosova dhe Islanda zotohen për thellim të bashkëpunimit ndërshtetëror

PRISHTINË, 29 NËNTOR (ER) - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, është pritur të enjten në takim nga ministri i Punëve të Jashtme i Islandës, Gudlaugur Thor Thordarson, me të cilin ka diskutuar për proceset që po kalon Kosova si dhe për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve. Me këtë rast, ministri i Punëve të Jashtme të Islandës, Gudlaugur Thor Thordarson, ka thënë se deri më tani Islanda ka përkrahur

Kosovën dhe kjo përkrahje do të vazhdojë edhe në të ardhmen për lëvizjen e lirë dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare.

Ministrja Hoxha ka falënderuar ministrin islandez Thordarson për gatishmërinë e përkrahjes së këtij vendi mik për integrim të Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare si dhe ka shprehur përkushtimin e institucioneve të Kosovës për thellimin e bashkëpunimit me Islandën.



Flet për "Epokën e re", Adem Grabovci

# BE-ja t'i bëjë presion

**- Dorëheqjet e kryetarëve të komunave në veri të Kosovës janë bërë në koordinim me Beogradin zyrtar**  
**- Pozita dhe opozita, kur është në pyetje përballja me Serbinë, duhet të bashkohen dhe të flasin me një zë**

Anëtari i Kryesisë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Adem Grabovci, e ka quajtur të vonuar dhe të paanalizuar mirë vendimin e Qeverisë për vendosjen e taksës prej 100 përqindësh për produktet me origjinë nga Serbia. Pavarësisht prej kësaj, ai i ka dhënë mbështetje këtij vendimi. Grabovci ka thënë se për shkak të fushatës së egër të Serbisë karshi Kosovës ndaj shtetit serb do të duhej të ketë reciprocitet të plotë në të gjitha fushat. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Grabovci i ka vlerësuar të padrejta reagimet e zyrtarëve të BE-së karshi këtij vendimi. Ai ka theksuar se BE-ja duhet të reagojë ndaj qasjes destruktive dhe armiqësore të Serbisë ndaj Kosovës dhe jo ndaj veprimeve mbrojtëse të shtetit tonë. Ndërsa sa i përket vendimit të dorëheqjes së kryetarëve të komunave në veri, Grabovci ka thënë se ky vendim ka qenë i nxitur nga Beogradi zyrtar



**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 29 NËNTOR** - Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Adem Grabovci, ka thënë se e mbështet vendimin e Qeverisë për vendosjen e taksës prej 100 përqindësh për produktet me prejardhje nga Serbia. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Grabovci ka vlerësuar se një vendim i tillë është dashur të merret më herët, duke pasur parasysh fushatën e egër të Serbisë ndaj Kosovës. "Këto veprime është dashur të merren më herët dhe të analizohen në detaje. Kur është në pyetje Serbia, unë jam për reciprocitet të plotë me këtë shtet, i cili ka qasje armiqësore ndaj shtetit të Kosovës. Është e pandershme që Serbia në njërin anë të luftojë me të gjitha mjetet, në anën tjetër përfiton nga Kosova miliona euro në vit në emër të tregtisë", ka thënë Grabovci.

Ndërsa sa i përket reagimeve të zyrtarëve të Bashkimit Evropian (BE) për vendosjen e kësaj takse, Grabovci ka thënë se këto reagime janë të padrejta. Ai ka thënë se BE-ja do të duhej të reagojë ndaj veprimeve destruktive të Serbisë. "BE-ja duhet të reagojë njëzëri dhe ashpër ndaj veprimeve destruktive të Serbisë, dhe jo ta tolerojë çdo veprim të saj. Ju i keni parë dhe dëgjuar thirrjet e liderëve serbë të cilat janë luftënxitëse dhe të papranueshme. Prandaj BE-ja në vend se të bëjë reagime të tilla, duhet ta disiplinonjë Serbinë, e cila është duke shkelur çdo parim dhe marrëveshje në raport me Kosovën. BE-ja duhet t'i bëjë pre-

sion Serbisë për të pagjeturit, viktimat e dhunës seksuale të luftës, dëmet e luftës etj", ka thënë Grabovci.

Më tutje, Grabovci ka komentuar edhe dorëheqjen e kryetarëve të komunave në veri të Kosovës. Ai ka thënë se këto dorëheqje janë bërë me "izën" e Beogradit. "Një veprim i tillë është i nxitur nga Beogradi, pra është bërë në koordinimin të plotë me drejtuesit e Serbisë, të cilët serbët e Kosovës i shohin vetëm si mjet kusurritje. Në këtë kontekst, Serbia nuk është e interesuar për zgjidhje të problemeve, por për thellimin e tyre dhe, rrjedhimisht, për destabilizim të Kosovës dhe rajonit në përgjithësi", është shprehur ai. Në këtë intervistë Grabovci ka folur edhe për procesin e dialogut me Serbinë dhe për zgjedhjet e brendshme në PDK. Sa iu përket zgjedhjeve brenda PDK-së, Grabovci ka thënë se nga ky proces kjo parti do të dalë më e konsoliduar dhe më e strukturuar.

**"Epoka e re":** Z. Grabovci, si e vlerësoni vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës prej 100 përqindësh ndaj produkteve të Serbisë?

**Grabovci:** Personalisht e mbështes vendosjen e taksës ndaj produkteve me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Pavarësisht prej kësaj, mendoj se këto masa janë paksa të vonuara dhe të paanalizuara mirë. Këto veprime është dashur të merren më herët dhe të analizohen në detaje. Kur është në pyetje Serbia unë jam për reciprocitet të plotë me këtë shtet, i cili ka qasje armiqësore ndaj shtetit të Kosovës. Është e pandershme që Serbia në njërin anë të luftojë me të gjitha mjetet, në anën tjetër përfiton nga Kosova miliona euro në vit në emër të tregtisë. Kjo është e pandershme dhe nuk duhet të tolerohet.

shme që Serbia në njërin anë të luftojë me të gjitha mjetet, në anën tjetër përfiton nga Kosova miliona euro në vit në emër të tregtisë. Kjo është e pandershme dhe nuk duhet të tolerohet.

**"Epoka e re":** Ky vendim ka marrë mbështetje popullore, por ka pasur reagime të ashpër nga Bashkimi Evropian (BE).

**Grabovci:** Reagimet e zyrtarëve të Bashkimit Evropian (BE) janë të padrejta. BE-ja duhet të reagojë njëzëri dhe ashpër ndaj veprimeve destruktive të Serbisë, dhe jo ta tolerojë çdo veprim të saj. Ju i keni parë dhe dëgjuar thirrjet e liderëve serbë të cilat janë luftënxitëse dhe të papranueshme. Prandaj BE-ja në vend të bëjë reagime të tilla, duhet ta disiplinonjë Serbinë, e cila është duke shkelur çdo parim dhe marrëveshje në raport me Kosovën. BE-ja duhet t'i bëjë presion Serbisë për të pagjeturit, viktimat e dhunës seksuale të luftës,

dëmet e luftës etj. Si duket, BE-ja ka harruar se Serbia ka qenë agresorja, ndërsa Kosova viktimë e saj. Po ashtu, BE-ja duhet ta dijë se Kosova çdoherë ka qenë dhe është e gatshme t'i përgjigjet drejtësisë ndërkombëtare, derisa në Serbi kriminelët e luftës sillen të lirë, madje bashkëpunëtorët kryesorë të kasapit të Ballkanit, Slobodan Millosheviçit, janë në krye të shtetit serb. Prandaj, BE-ja duhet të tregohet më e ashpër ndaj Serbisë, e cila nuk është e interesuar për zgjidhjen e problemeve me Kosovën, por për themelimin e tyre.

**"Epoka e re":** Sipas jush, a ka ndikuar kjo taksë në dorëheqjen e katër kryetarëve të komunave në veri të Kosovës?

**Grabovci:** Vendimi i kryetarëve serbë të komunave në veri të Republikës së Kosovës për dorëheqje është i pamatur, joracional dhe kundër interesave të qytetarëve

serbë atje. Një veprim i tillë është i nxitur nga Beogradi, pra është bërë në koordinimin të plotë me drejtuesit e Serbisë, të cilët serbët e Kosovës i shohin vetëm si mjet kusurritje. Në këtë kontekst, Serbia nuk është e interesuar për zgjidhje të problemeve, por për thellimin e tyre dhe, rrjedhimisht, për destabilizim të Kosovës dhe rajonit në përgjithësi. Është momenti i fundit që bashkësia ndërkombëtare të merret seriozisht me Serbinë. Po ashtu, është momenti i fundit që edhe faktori politik në Kosovë të jetë i unifikuar në proceset nëpër të cilat është duke kaluar Kosova.

**"Epoka e re":** Duke e parë këtë situatë, ia vlen të dialogohet me Serbinë?

**Grabovci:** E para, dialogu është i paalternativë. Republika e Kosovës nuk ka arsye ta refuzojë dialogun si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Serbinë. E dyta, Kosova duhet të insistojë në

# Serbisë, jo Kosovës



zbatimin e marrëveshjeve të arritura deri më tani, pasi Serbia është duke e shkelur çdo marrëveshje. Ju e keni parë qasjen e Serbisë në raport me Interpolin, ku veprimet e saj janë në kundërshtim të plotë me Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013. Në anën tjetër, kur është në pyetje përballja me Serbinë, partitë politike në Kosovë, pozitë dhe opozitë, duhet të bashkohen dhe të flasin me një zë. Nuk është koha për ndarje, por për bashkim të forcave. Këtë e them kur shoh parti politike që më shumë bëjnë zhurmë pse presidenti Hashim Thaçi është duke kërkuar unifikim të spektrit politik sesa kundër qasjes destruktive të Serbisë në raport me Kosovën. Vlerësoj se angazhimet e presidentit Thaçi janë në përputhje të plotë me interesin shtetëror dhe qytetar. Takimet e tij të fundit me liderët botërorë në Paris apo Uashington e dëshmojnë këtë. Në këtë aspekt, veprimet e Thaçit nuk bien ndesh me interesat nacionale. Është e papranueshme për mua kur dëgjoj zëra të llojit 'ta mbrojmë Kosovën nga presidenti', kur dihet fare mirë angazhimi i Thaçit në të gjitha proceset historike, nga periudha ilegale, angazhimi në UÇK, Rambuje, Vjenë, shpalljen e Kosovës shtet dhe në procesin e konsolidimit dhe të shtetndërtimit. Dhe, e treta, BE-ja nuk duhet t'i mbyllë sytë përballë politikës shoviniste të Serbisë karshi Kosovës. Pra, BE-ja duhet t'ia bëjë të qartë Serbisë, se politika e saj karshi Kosovës nuk dërgon kah paqja, por kah destabiliteti rajonal. Në këtë kontekst, besoj fuqishëm se pa përfshirjen e ShBA-së nuk mund të ketë dialog të suksesshëm. Pra, përfshirja e Amerikës në këtë proces dhe fazë është e domosdoshme.

**"Epoka e re":** Z. Grabovci, PDK-ja është në proces të brendshëm zgjedhor. Si është duke shkuar ky proces, dhe cilat janë pritjet e juaja?

**Grabovci:** Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është parti e dëshmuar në shtetndërtimin dhe në zhvillimin e vendit. Të gjitha proceset e rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar Kosova mbajnë vulën e PDK-së. Për dikë kanë qenë të pakapshme projektet që janë realizuar nën qeverisjen e PDK-së siç janë: autostrada, infrastruktura rrugore, ndërtimi i shkollave etj. Ju e dini se infrastruktura është bazamenti i ekonomisë së lirë të tregut. Tani kur jemi te zgjedhjet e brendshme, pritjet e mia janë që PDK-ja do të dalë më e strukturuar dhe më e organizuar. Më herët PDK-ja ka përmbyllur suksesshëm zgjedhjet në rininë demokratike. Nga ai proces ka dalë një lidhshmëri shumë e konsoliduar, me një përfshirje të gjerë. Zgjedhjet në rininë demokratike kanë dëshmuar se PDK-ja është parti e hapur dhe se u jep hapësirë të gjithëve. Në këtë drejtim, besoj fuqishëm se PDK-ja do të dalë më e fuqishme se kurrë nga procesi zgjedhor për organet drejtuese. Këto e shoh çdo ditë nga kontaktet që kam me votues dhe qytetarë anekënd vendit. PDK-ja ka nevojë për energji të re dhe personalitete të reja të cilat do ta pasuronin edhe më shumë këtë parti. Po ashtu, PDK-ja është duke punuar që të aktivizohen të gjithë ata burra dhe gra që janë pasivizuar, me apo pa te drejtë, në mënyrë që ta japin kontributin e tyre për shfuqizimin e PDK-së, por edhe të Kosovës. Me fjalë të tjera, nga ky proces zgjedhor pres që autoritetet e dëshmuara të PDK-së, apo themeluesit e kësaj partie të bashkudhëtojnë së bashku me gjeneratat e reja për një PDK më të fuqishme.

## Qeveria: Tarifatat nuk janë kundër serbëve të Kosovës, por kundër Serbisë

PRISHTINË, 29 NËNTOR (ER) - Qeveria e Kosovës përmes një deklarate për media ka hedhur poshtë, siç thuhet, pretendimet nga aktorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit, se masa prej 100 përqindësh ndaj produkteve të importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, është drejtuar kundër qytetarëve serbë të Kosovës. Këto pretendime Qeveria e Kosovës i konsideron "të pavërta, të paqëndrueshme dhe të papranueshme". "Ky vendim sovran i Kosovës vjen si rezultat i pengesave të vazhdueshme që Serbia po ia bën vendit tonë", thuhet në deklaratë të Qeverisë.

Qeveria ka sqaruar se nga kjo masë mbrojtëse përjashtohen të gjitha donacionet për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor. "Kjo nënkupton donacionet për kisha dhe objektet fetare; misionet diplomatike ose konsullore dhe personeli i tyre, përveç personelit të punësuar vendor, kanë të drejtë të importojnë mallra, të liruara nga tatimi doganor, që janë për përdorim zyrtar dhe ekskluziv nga misioni ose për përdorim personal ekskluziv të personelit të misionit, përveç personelit të punësuar në vend", theksohet në deklaratë. Po ashtu, masa "nuk aplikon tarifa për

importet e mallrave të financuara nga fitimet e granteve të dhëna nga qeveritë, agjencitë qeveritare, organizatat qeveritare apo joqeveritare që veprojnë jashtë apo brenda Republikës së Kosovës, të dhëna për Qeverinë apo përmes Qeverisë së Republikës së Kosovës për t'i ndihmuar programet dhe projektet humanitare si dhe ato të rindërtimit në Kosovë", thuhet në deklaratën e Qeverisë. Gjithashtu, sqarohet se tarifatat nuk vlejnë as për dërgesat dhe lirimet për KFOR-in dhe EULEX-in. Ngjashëm thuhet se tarifa nuk vlen as për mallrat që barten në bagazhin privat të udhëtarëve.




## Inaugurohet Qendra e Inovacionit në Universitetin e Prishtinës

PRISHTINË, 29 NËNTOR (ER) - Të enjten është bërë inaugurimi i Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Universitetin e Prishtinës. Në ceremoninë e mbajtur me këtë rast kanë marrë pjesë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj, ministri Besim Beqaj, dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike (FIM), Ahmet Shala, profesorë dhe studentë të shumtë. Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, në fjalën e mbajtur në këtë ceremoni ka folur për rëndësinë e Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në UP, duke theksuar se kjo gjë është bërë në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës "Hasan

Prishtina" dhe me Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike. "Unë besoj fuqishëm, kështu beson edhe kryeministri dhe kryetari i Kuvendit, se e vetmja fuqi konkurruese në kohën e digjitalizimit është rinia, pasi është promotorja dhe gjeneratorja e zhvillimit ekonomik", ka thënë ministri Beqaj. Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka folur për rëndësinë e lidhjes së zhvillimit ekonomik dhe arsimit. "Hapja e Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Universitetin e Prishtinës është një hap tejet i rëndësishëm në kuadër të përmbushjes së programit tonë qeverisës. Kjo qendër do të jetë një hapësirë që studentët të punojnë

në idetë e tyre për projekte të ndryshme, që do të kontribuojnë për hapjen e bizneseve të reja dhe zhvillimin e atyre ekzistuese, që mundësojnë vende të reja pune", ka thënë Veseli.

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se të gjithë në Kosovë e kuptojnë rëndësinë e arsimit dual dhe këtu po jepet shembulli i kujdesit kombëtar për arsimin dhe kjo të shërbejë si një nisje për këtë. "Do ta kemi vështirë të mbetemi garues në tregun ekonomik në vend, qoftë edhe me taksa që i kemi vendosur, nëse nuk i zhvillojmë aftësitë e tjera që të mund të tërheqim investime", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke theksuar se pikërisht për këtë arsi-




mi dual është i rëndësishëm. Para të pranishmëve kanë folur edhe dekani i FIM-së, Ahmet Shala dhe Myrvete Badivuku-Pantina, prorektore e UP-së. Pjesëmarrësit

në ceremoni kanë vizituar edhe hapësirat e destinuara për Qendrën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në UP dhe laboratorët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

## Klinika e Neurokirurgjisë ia heq pacientes tumorin që ia kishte verbuar syrin

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Në Klinikën e Neurokirurgjisë të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK) një pacienteje i është hequr me sukses tumori që ia kishte verbuar syrin. "Pacientes K. R (1964) i ishte verbuar syri i djathtë si pasojë e një tumori të bazës së trurit. Tumori pacientes i kishte verbuar syrin e djathtë. Pas përgatitjes preoperatorë, më 21. 11. 2018 pacientja operohet në Klinikën e Neurokirurgjisë nga tumori i bazës së kokës me diagnozë Tu frontobasalis-Meningioma tubercullum sellae (tumor i regjionit ballor të bazës së trurit), që është një rast shumë sfidues për nga aspekti neurokirurgjik", ka njoftuar QKUK-ja. Sipas këtij njoftimi, ky operacion ka zgjatur nëntë orë, me ç'rast masa tumorale është larguar në tërësi. "Pacientja postoperativisht është pa deficite neurologjike evidente. CT-ja e kokës kontrolluese është realizuar dhe është pa mbetje tumorale. Pacientja është hospitalizuar në klinikë, pasi e njëjta ka pasur vështirësi në të parë



dhe i ishte verbuar syri i djathtë. Me imazheri radiologjike (MRI) është diagnostifikuar shkaktari. Në aspektin shkencor, tumoret e

tilla për nga natyra janë beninjë, por lokalizimi i tyre është 'malinj'. Rasti në fjalë është tejet sfidues për operim edhe për

qendrat më të sofistikuara botërore andaj kjo e bën qendrën tonë të veçantë", është thënë në këtë njoftim. QKUK-ja

ka bërë me dije se vlera e operimeve të tilla në institucione jashtë vendit është 60 000 deri në 80 000 euro.

## Ministri Mustafa në Sllovaki flet për migracionin dhe luftën kundër krimit të organizuar

BRATISLAVË, 29 NËNTOR (ER) - Në Bratislavë të Sllovakisë më 28 dhe 29 nëntor u mbajtën punimet e Forumit të Salzburgut. Përveç anëtarëve, në forum morën pjesë edhe shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe disa institucione të BE-së. Fokusi kryesor i forumit u përqendrua në bashkëpunimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor me shtetet e BE-së në menaxhimin e flukseve të migrimit përgjatë "rrugës" së Ballkanit Perëndimor, si dhe bashkëpunimi

në luftimin e kontrabandës me narkotikë, armë dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Republika e Kosovës u përfaqësua nga ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, i cili të pranishmëve në forum u foli rreth migracionit dhe bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar. Ministri Mustafa, duke trajtuar çështjen e migracionit, ka theksuar se Kosova ende nuk është prekur nga lëvizjet e mëdha të flukseve të

migrimit, megjithatë ka përgatitur planin e reagimit, i cili do të aktivizohet në rast se paraqitet ndonjë fluks i mundshëm. "Për Kosovën është me rëndësi rritja e bashkëpunimit përmes shkëmbimit të informatave në mënyrë të drejtpërdrejtë me agjencitë e BE-së, por edhe me shtetet anëtare në mënyrë që të rritet efikasiteti i agjencive të zbatimit të ligjit për reagim proaktiv ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve", ka thënë Mustafa.



## Mustafa thotë se Veseli dhe Haradinaj po bëhen pjesë e projektit për ndarjen e veriut

PRISHTINË, 29 NËNTOR (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj dhe disa ministra janë duke u bërë pjesë e projektit për ndarjen e veriut. Ai në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se presidenti Hashim Thaçi nuk është i vetëm për

idenë për korrigjimin e kufijve. "Institucionet e vendit nuk po sillen me përgjegjësi ndaj gjendjes së krijuar në veri të vendit. Sjellja, veprimet dhe mosveprimet e Qeverisë dhe të Kuvendit, pa marrë parasysh se çfarë deklaron kryetari i Kuvendit, kryeministri dhe disa ministra, po bëhen pjesë e projektit të ndarjes së veriut të

Kosovës. Po shihet qartë se presidenti nuk është vetëm në idenë e tij për korrigjim të kufijve. Është e papranueshme që për efekte populiste e të fushatës të rrezikohet integriteti territorial dhe ushtrimi i pushtetit në tërë territorin e vendit. Institucionet e tilla të papërgjegjshme duhet të japin dorëheqje dhe të shpërnda-hen", ka shkruar Mustafa.



## Sistemi informativ i tregut të punës, në dispozicion të qytetarëve

Me rastin e lansimit të sistemit informativ të tregut të punës, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka bërë me dije se shkëmbimi i informacioneve në mes të punëdhënësve dhe punëmarrësve ka qenë sfidë me të cilën është përballur MPMS-ja. Tanimë, sipas tij, ky sistem do të krijojë lehtësira në shkëmbimin real të të dhënave



**EPOKA  
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), përkrahur nga Projekti për Punësimin e të Rinjve (EYE), projekt ky i SDC-së, kanë lansuar të enjten sistemin informativ të tregut të punës. Ky sistem ka për qëllim të sigurojë informacione lidhur me punësimin dhe karrierën për studentët, të papunët, punëkërkuarit, prindërit, si dhe këshilltarët për karrierë, duke mbledhur një sërë të dhënash nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (rreth regjistrimit të popullsisë, Anketa e Fuqisë Punëtore), nga MASHT-i (statistikat e arsimit), MPMS-ja (të papunësuarit e regjistruar, përfituesit e asistencës sociale, vendet e lira të punës etj.), nga

Administrata Tatimore (shifrat zyrtare të punësimit), MTI-ja (regjistri i bizneseve) në një platformë të përbashkët që do të ofrojë informacione të përditësuara mbi trendin dhe tendencat në tregun e punës në Kosovë. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se lansimi i sistemit informativ të tregut të punës, ku do të grumbullohen të gjitha informatat e tregut të punës, përfshirë këtu edhe modulën e orientimit në karrierë, do ta lehtësojë rrugën për të ofruar trajnime profesionale, duke u bazuar në

nevojat e tregut të punës si dhe shkollave të mesme profesionale që të hartojnë kurrikula përkatëse sipas nevojave të tregut. "Uroj përzemërsisht të gjithë ju që keni punuar për të lansuar sot këtë program, në të njëjtën kohë bëj thirrje për bashkëpunim të të gjitha institucioneve që ta bëjmë këtë sistem storie suksesi dhe model për vendet e rajonit", ka thënë Reçica, duke shtuar se shkëmbimi i informacioneve mes punëdhënësve dhe punëmarrësve ka qenë sfidë me të cilën jemi përballur dhe tanimë ky sistem

do të krijojë lehtësira në shkëmbimin real të të dhënave. "Orientimi në karrierë i të rinjve, si parakusht për zbutje të papunësisë, është objektiv yni dhe një sistem i shkëmbimit të informacioneve rreth nevojave të tregut të punës do ta lehtësojë arritjen e këtij qëllimi", ka thënë ministri Reçica. Zëvendësperfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Kosovë, Alessandra Roccasalvo, ka theksuar rëndësinë që sistemi do ta ketë në të ardhmen. "Bota ka prodhuar më shumë të dhëna vetëm gjatë vitit 2017 sesa në

tërë historinë paraprake të njerëzimit. Pra, të dhënat janë atje. Ne vetëm duhet t'i kemi mjetet dhe njohuritë për t'i shfrytëzuar dhe për të siguruar qasje gjithëpërfshirëse në këto të dhëna për qytetarët. Prandaj unë jam i lumtur që jam këtu me shumë nga partnerët tanë për lansimin e Sistemit Informativ të Tregut të Punës, një mjet i shkëlqyeshëm për t'i ndihmuar politikëbërësit, sektorin privat, si dhe studentët dhe ata që hyjnë në tregun e punës për të bërë zgjedhje të drejta", ka thënë Roccasalvo.

## MASHT-i ndalon përdorimin e telefonit gjatë procesit mësimor

PRISHTINË, 29 NËNTOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në funksion të përmirësimit të mbarëvajtjes së procesit mësimor në shkollë dhe të ngritjes së cilësisë në arsim, ka nënshkruar të enjten vendimin

për ndalimin e përdorimit të telefonit gjatë procesit mësimor nga mësuesit dhe nxënësit në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës. Sipas këtij vendimi, për zbatimin e tij vendimi ngarkohet sekretari i

përgjithshëm i MASHT-it, drejtoritë komunale të arsimit dhe drejtorët e institucioneve të arsimit parauniversitar, të cilët janë edhe përgjegjës për marrjen e masave sipas legjislacionit në fuqi në rast të shkeljes së tij.



## Sot mbahet takimi i deputetëve me qytetarët e Suharekës

Suharekë, 29 nëntor (ER) - Në vazhdim të aktivitetit "Ditët e Kuvendit" sot (e premte) mbahet takimi i deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës me qytetarët të Suharekës. Takimi mbahet në Sallën e Kuvendit të Komunës

në Suharekë dhe fillon në orën 14:00. Gjatë këtij takimi publik qytetarët e Suharekës do të kenë mundësinë të diskutojnë me deputetët: Driton Selmanaj, Luljeta Veselaj-Gutaj, Salih Zyba, Blerim Kuçi dhe Albulena Balaj-Halimaj.



Driton Selmanaj



Luljeta Veselaj Gutaj



Salih Zyba



Blerim Kuçi



Albulena Balaj Halimaj



## Suspendohen katër inspektorë të ndërtimit në Prizren

PRIZREN, 29 NËNTOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se ka suspenduar katër inspektorë nga sektori i ndërtimit nga kjo komunë. "Komisioni disiplinor gjatë javës ka sus-

penduar katër inspektorë për shkak të neglizhencës në punë dhe për shkak të të gjeturave në terren. Deri te kjo masë ka ardhur nga mosraportimi i saktë nga terreni, konkretisht për

gjendjen e objekteve në ndërtim e sipër. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ky veprim sanksionohet me masë të përkohshme të suspendimit", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



## Nënshkruhet marrëveshja për avancimin e pozitës së të rinjve të Skenderajt

SKENDERAJ, 29 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe Koordinatori Nacional i Programit për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, në një ceremoni ku të pranishëm ishin edhe zëvendësministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Azem Guri dhe drejtori për Arsim në Skenderaj, Bekim Latifi, kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për avancimin e pozitës së të rinjve në fushat e sportit, kreativitetit kulturor dhe garave për dituri.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i angazhimeve të

ndërsjella në mes të Qeverisë së Kosovës dhe institucionet e tjera përkatëse për realizimin e projekteve konkrete në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit në Republikën e Kosovës. Nëpërmjet kësaj marrëveshje synohet përforcimi i kapaciteteve intelektuale, kulturore e sportive të rinisë kosovare, si dhe promovimi i bashkëpunimit të ndërsjellë në fusha të interesit të përbashkët të të dyja palëve.

Disa prej fushave të bashkëpunimit sipas kësaj marrëveshjeje do të jenë: shkëmbimi i përvojave dhe mbështetja e ndërsjellë për projektet rreth rin-

isë, kulturës dhe sportit, aranzhimi i përbashkët i Komunës së Skenderajt dhe institucioneve qendrore për aktivitetet që kanë për synim grumbullimin e donacioneve ndërkombëtare për projektet që promovojnë kulturën dhe sportin, pastaj angazhimin e përbashkët rreth ecurisë dhe mbajtjes së garave sportive, të diturisë dhe kreativitetit kulturor, si në nivelin shkollor lokal/komunal, po ashtu edhe në atë qendror, si dhe bashkëpunim në ndërhyrje në infrastrukturën sportive duke ofruar bashkëpunim dhe zhvillim të garave.

## Latifi bisedon me përfaqësuesit e bizneseve për organizimin e një panairi në Rahovec

RAHOVEC, 29 NËNTOR (ER) - Në sallën e Kuvendit Komunal të Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur të enjten takim me përfaqësuesit e bizneseve prodhuese dhe përpunuese, me të cilët ka diskutuar për organizimin e panairit me prodhime vendore të komunës dhe promovimin e tyre.

Latifi ka falënderuar përfaqësuesit e bizneseve të pranishëm në takim, më pas u ka thënë atyre se qëllimi i takimit është organizimi i panairit me prodhime vendore të komunës dhe promovimi i tyre. "Më shumë sesa në Rahovec që ka prodhime vendore nuk ka në asnjë komunë tjetër të Kosovës, për këtë arsye planifikojmë ta organi-

zojmë një panair. Andaj kërkoj nga ju që ta mbështetni këtë iniciativë, në mënyrë që ky panair të jetë edhe më i suksesshëm", është shprehur kryetari Latifi.

Përfaqësuesit e bizneseve, që ishin të pranishëm në takim, e mbështetën propozimin e kryetarit Latifi për organizimin e panairit dhe u shprehën të gatshëm të kontribuojnë dhe të jenë pjesëmarrës në panair, me produktet të cilët ata prodhojnë. Gjatë takimit u formua këshilli organizativ prej dhjetë anëtarësh për organizimin e panairit dhe u tha që për kohën, vendin e mbajtjes dhe zgjatjen e panairit do të vendosë këshilli gjatë takimeve që do t'i mbajë në ditët e ardhshme.





# Ministri Shala u bënë thirrje qytetarëve të konsumojnë produkte vendore

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Me pjesëmarrjen e 300 kompanive prodhuese nga Kosova dhe mbi 70 kompanive nga Shqipëria dhe Maqedonia ka filluar të enjten Konventa e Parë e Prodhuesve të Kosovës organizuar nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK). Me këtë rast, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, në konventën e Klubit të Prodhuesve ka theksuar nevojën që produktet vendore të konsumohen nga qytetarët. Shala ka thënë se patriot është ai që hap vende pune dhe konsumon produkte vendore që ndikon në fuqizimin e ekonomisë. Ai ka theksuar se është kënaqësi kur sheh që përkrahja e produkteve vendore nga ana e qytetarëve ka marrë përmasa të jashtëzakonshme. "Patriot për mua është ai që sot hap vende të reja të punës, konsumon produkte vendore dhe ndikon në fuqizimin e ekonomisë së Kosovës, e me këto ndikon në mosikjen e të rinjve tanë nga

vendi", ka thënë ministri Shala. Ai ka shtuar se prodhuesit vendorë sot janë në një pozitë më të mirë se në të kaluarën, duke shtuar se ky fakt e gëzon, pasi ndikon edhe në bilancin tregtar që e ka Kosova. Ai iu ka dhënë mbështetje prodhuesve vendorë, duke u premtuar atyre se do të jetë krah i tyre që Kosova të bëhet model i zhvillimit, në të njëjtën kohë ka kërkuar edhe rritje të cilësisë së produkteve. "Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është e angazhuar shumë që të jetë krah i prodhuesve vendorë, duke punuar bashkërisht që Kosovën ta bëjmë model për zhvillim. Po punojmë shumë që të kemi një ekonomi bazuar te nxitja e investimeve prodhuese dhe te një vizion i ri për mënyrën se si Kosova mund t'i shfrytëzojë potencialet që i ka konsumatori ynë, partnerët tanë tregtarë, nuk duhet ta kenë asnjë dilemë sa i përket cilësisë së produkteve tona. Prandaj unë kërkoj nga ju ta rrisni cilësinë, e cila ka shumë rëndësi sot, po ashtu bëj apel te qytetarët që të konsumojnë produkte vendore", ka



## Panxha: Prodhimi, sektori më strategjik i Kosovës

Drejtori ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Astrit Panxha, në hyrje të Konventës ka deklaruar se prodhuesit në Kosovë po përballen me shumë sfida. "Prodhimi është sektori më strategjik i Kosovës. Konventa është organizuar me qëllim që t'u tregojmë se në Kosovë ka prodhim,

por ka edhe shumë sfida. Klubi i Prodhuesve të Kosovës është pro tregtisë së lirë. Kemi ftuar bashkëpunëtorë nga Shqipëria dhe Maqedonia që të bashkëpunojmë", ka thënë Panxha. Ai ka theksuar se prodhuesit nga Kosova po kanë vështirësi të depërtojnë në Serbi dhe Bosnjë Hercegovinë.

thekuar Shala.

Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se taksa 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës është vendim sovran i Kosovës. "Taksa 100 për qind, si vendim sovran i Kosovës, le të shërbejë si porosi për të gjithë se ne jemi zgjuar, të vetëdijshëm dhe se jemi vetvetja. Prodhuesit vendorë e kanë përpara një periudhë të artë, të cilën duhet ta shfrytëzo-

jnë për fuqizimin dhe qëndrueshmërinë në treg. Reforma fiskale, që i fuqizon ata dhe taksa për importet nga Serbia dhe Bosnja Hercegovina, u ka krijuar atyre rrethana më të favorshme, duke ua hequr barrën e diskriminimit. Kosova tani ka më shumë vetëbesim dhe prodhuesit tanë po e fitojnë besimin e konsumatorëve në tregun tonë dhe në atë evropian", ka thënë Haradinaj.

# Oda Amerikane shpreh shqetësimin për mungesën e dialogut publiko-privat

PRISHTINË, 29 NËNTOR (ER) - Oda Amerikane nëpërmjet një komunikate për media ka vlerësuar se fuqizimi i dialogut publiko-privat është një parakusht për garantimin e një mjedisi të sigurt për investime. Oda Ekonomike Amerikane beson fuqishëm se sektori privat, si hisedari më i rëndësishëm në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, duhet ta ketë mundësinë për dhënien e kontributit të tij në hartimin e politikave publike që do të mundësonin fuqizimin e sektorit privat, tërheqjen e

investimeve të huaja direkte, luftimin e korrupsionit si dhe fuqizimin e sundimit të ligjit. "Është për keqardhje që një sërë vendimesh dhe projektligjesh të aprovuara së fundmi

janë bërë pa diskutim të mirëfilltë mes palëve të interesit, përfshirë këtu edhe sektorin privat dhe përfaqësuesit e tyre. Në këtë aspekt, Oda Amerikane shpreh shqetësimin e saj edhe

për mosfunksionimin e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik si një mekanizëm i cili përgjatë viteve të kaluara ka ofruar mundësi unike për zhvillimin e dialogut publiko-

privat dhe paraqitjen në mënyrë institucionale të kërkesave të komunitetit të biznesit për institucionet shtetërore", është thënë në komunikatën për media të Odës Amerikane.

Oda Amerikane edhe një herë ka përsëritur thirrjen për fuqizim të dialogut dhe për rifunksionalizim të mekanizmave formalë të dialogimit, duke shprehur zotimin e saj për kontribut të vazhdueshëm konstruktiv në funksion të përsheptimit të zhvillimit ekonomik dhe nxitjes së investimeve të sektorit privat.



AMERICAN CHAMBER OF  
COMMERCE IN KOSOVO

## Xhevdet Tahiri emërohet ushtrues detyre i drejtorit të "Trepçës"

PRISHTINË, 29 NËNTOR (ER) - Bordi Mbikëqyrës i "Trepçës" sh. a., bazuar në kompetencat mbi Ligjin për

"Trepçën" si dhe legjislacionin tjetër në fuqi, në mbledhjen e mbajtur më 27. 11. 2018 ka emëruar në poz-

itën e ushtruesit të detyrës së menaxherit Xhevdet Tahirin. Tahiri është magjistër i shkencave të

xehetarisë dhe ka mbi 15 vjet përvojë pune në ndërmarrjen "Trepça". Ushtruesi i detyrës së menaxherit të "Trepçës"

është zotuar se do të punojë me përkushtim të madh me qëllim të përmirësimit të situatës në prodhim.

# SHKËMBIMI



**Rexhep QOSJA**

Ideja e shkëmbimit të territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë, e bërë publike shumë vite më parë, por e përditësuar dy muajt e fundit, tashmë është ngritur në nivelin e çështjes për të cilën po flitet në gjithë hapësirën shqiptare, madje edhe në diasporë. Çështja e shkëmbimit të territoreve është çështje, çështje politike e kombëtare e madhe, sepse është çështje që i përket tërësisë territoriale të Kosovës, tërësisë territoriale të Serbisë dhe, rrjedhimisht, qëndrueshmërisë në rajon, para së gjithash, në rajonin e të ashtuquajturit Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë çështja e shkëmbimit të territoreve ende nuk është bërë çështje e bisedimeve, për të e kanë quajtur të nevojshme, dhe të arsyeshme, ta thonë mendimin e tyre institucione shtetërore të Kosovës e të Shqipërisë, struktura drejtuese të partive politike në Kosovë, të partive politike në Shqipëri, të partive politike shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi, në Luginë të Preshevës e në diasporë, mandej, intelektualë, studiues shkencorë, shkrimtarë dhe qytetarë të zakonshëm.

Për dallim prej institucioneve dhe vetjeve disa prej të cilëve merren edhe me përpjesëtimin e me përmbajtjen, domethënë me vetë projektin e shkëmbimit të territoreve, unë në këtë mes merrem vetëm e vetëm me konceptin, vetëm me çështjen e shkëmbimit të territoreve, i vetëdijshëm se përpjesëtimin e përmbajtjen e saj duhet ta përcaktojnë ekspertët e të dy palëve në bisedime.

Është e kuptueshme që prej gjithë këtyre institucioneve, gjithë këtyre drejtuesve të partive, gjithë këtyre intelektualëve dhe qytetarëve të zakonshëm të jenë dëgjuar mendime të ndryshme për shkëmbimin e territoreve, shpesh ndërsjellshëm plotësisht të mospajtueshme.

Ndër këto mendime ndërsjellshëm plotësisht të mospajtueshme mbizotërojnë, ndërkaq, mendimet e atyre institucioneve, atyre drejtuesve të partive politike, të atyre intelektualëve dhe të atyre qytetarëve të zakonshëm, që shkëmbimin e territoreve e mohojnë, duke e quajtur kundërkombëtar dhe të rrezikshëm për rajonin apo, madje, edhe më gjerë!

Nuk ka dyshim se autorët e këtyre mendimeve mbizotëroese kundër shkëmbimit të territoreve nxituan t'i shpërfillin shprehjet pothuaj mirëkuptuese ndaj lëvizjes së kufijve, domethënë ndaj shkëmbimit të territoreve mes Kosovës e Serbisë, që u dëgjuan nga figura të larta politike e shtetërore në administratën e SHBA-së e të disa vendeve të BE-së dhe në administratën e jashtë administratës së disa vendeve të tjera në botë, të cilat, ç'është e vërteta, më shpesh se mendime individuale ishin mendime zyrtare.

Nuk është e vështirë të vërehet se në deklaratim institucionale dhe individuale për shkëmbimin e territoreve, si edhe në gjykimet tona në lidhje me çështje të mëdha kombëtare, shoqërore, ekonomike e të tjera në përgjithësi, ndikim përcaktues ushtrojnë përkatësitë partiake, përkushtimet ndaj këtyre a atyre faktorëve ndërkombëtarë, përkushtimet pushtetore, formimi kulturor dhe informimi i përgjithshëm i të deklaruarve. Çështja e shkëmbimit të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë është çështje që, ndoshta, ndoshta mund të shtrohet në bisedimet mes shqiptarëve dhe serbëve në Bruksel dhe, si e thonë disa nga vëzhguesit e tyre, mund të shtrohet në mënyrë demagogjike prej kryetarit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, mund të shtrohet kur e kur edhe mistifikueshëm prej kryetarit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe mund të shtrohet qartë prej përfaqësueses së BE-së në këto bisedime, Federika Mogherini.

Si u pa, në këtë shumësi pikëpamjesh tona për çështjen e shkëmbimit të territoreve u shprehën edhe disa paqartësi kuptimore dhe nocionore. Në një sërë rastesh çështja e shkëmbimit të territoreve u mbulua me togfjalëshit korrigjim i kufijve, lëvizje e kufijve apo, madje, dhe ndarje e Kosovës. Keqkuptim të veçantë të çështjes së shkëmbimit të territoreve përfaqëson togfjalëshi ndarje e Kosovës. Me këtë togfjalësh në disa raste synohet

zhvlerësimi i skajshëm i çështjes së shkëmbimit të territoreve, i korrigjimit të kufijve, i lëvizjes së kufijve, që në asnjë rast nuk kanë qëllimin, prandaj as kuptimin e ndarjes së Kosovës.

Të gjithë ata që sadopak e dinë historinë e çështjes së Kosovës dhe të gjithë ata që qoftë si njerëz politikë qoftë si intelektualë janë marrë dikur me këtë çështje e dinë se farkues të idesë së ndarjes së Kosovës ishte politikani dhe shkrimtari serb, Dobrica Qosiq, me mirëkuptimin frymëzues të ish-ambasadorit amerikan në Beograd, Uoren Cimerman. Meqenëse Dobrica Qosiqi dhe politikanët e intelektualët serbë e synonin dhe e dëshironin ndarjen e Kosovës, është e kuptueshme pse shkëmbimi i territoreve, atëherë prej meje dhe më vonë prej ndonjë intelektualit tonë tjetër, i shprehur me togfjalëshin nocionor lëvizje e kufirit verior, nuk ishte dhe nuk mund të ishte ide e tyre - e serbëve në asnjë rast. Jo. Ideja e shkëmbimit të territoreve, koncepti i shkëmbimit të territoreve tashmë i ngritur në nivelin e çështjes, ishte, pra, ide e jona, e disa intelektualëve tonë, të cilët me të e mohonin idenë e ndarjes së Kosovës. Edhe me këtë ide, me idenë e shkëmbimit të territoreve atëherë në të vërtetë mbrohej ideja e tërësisë etnike dhe historike shqiptare të Kosovës me Luginën e Preshevës dhe mbrohej sepse Kosovës i merrej territor, por dhe më shumë i bashkohej territor.

E trajtuar në shkrimet e mia disa herë edhe pas luftës, kjo çështje do sjellë reagime mospajtuese të vrazhda, plot atdhetarizëm mëhalla, sidomos pas artikullit tim të botuar në muajin janar të vitit 2017.

Nuk është e çuditshme, prandaj, pse kundër çështjes së shkëmbimit të territoreve ishin atëherë dhe janë sot bartësit e përbetuar të nacionalizmit serbomadhi: Kisha Pravoslave Serbe në Serbi, në Bosnjë e Hercegovinë, në Kroaci, kudo në Ballkan dhe Kisha Pravoslave Serbe në SHBA, mandej intelektualët nacionalistë serbë në institucione të ndryshme të arsimit, të shkencës e të kulturës si dhe gati të gjitha partitë opozitare në Serbi.

Për idenë e shkëmbimit të territoreve sot në Serbi deklarohen kur qartë e kur mistifikueshëm kryetari i Serbisë dhe kryetar i Partisë më të madhe serbe, Partia Përparimtare Serbe, Aleksandar Vuçiq me partinë e

tij, me qeverinë dhe me shumicën në Kuvendin e Serbisë. Dhe, deklarohen me shpresën se ashtu e sigurojnë përkrahjen e Bashkimit Evropian, që po i përkrah stabilokracitë autoritare në shumicën e vendeve ish komuniste, posaçërisht në Serbi e në Kosovë!

Shumësia e deklaratimeve tona institucionale, partiake e individuale, kundër shkëmbimit të territoreve midis Kosovës e Serbisë në të vërtetë e tregon deshëm s'deshëm gjendjen e pamerenduar të politikës sonë të sotme në përgjithësi. Gjendja e mosmerenduar, në të vërtetë e diletantizuar e politikës sonë shtetërore është aq shumë e përmbytur saqë kryetari i shtetit flet për korrigjim të kufirit (pa guximin moral që ta quajë shkëmbim të territoreve çka ai korrigjim edhe është), kurse kryeministri atë korrigjim e quan hyrje në luftë!

Në institucionet politike e shtetërore dhe në mendjet e atyre që vendosin sot në emrin e Kosovës edhe për çështje madhore siç janë bisedimet me pushtuesin njëshekullor të Kosovës me dashje a pa dashje ende nuk dihet edhe çka do të duhej të dihej, nuk bëhet e thuhet edhe çka do të duhej të bëhej e të thuhet dhe bëhet e thuhet edhe çka nuk do të duhej të bëhej e të thuhet.

Çka do të duhej të dihej në këto institucione dhe çka do të duhej të dihej prej këtyre përfaqësuesve politikë e shtetërorë të popullit shqiptar të Kosovës e, si po shihet, ende nuk dihet apo nuk shihet se dihet!

1. Do të duhej të dihej se sot midis të pushtuarit dhe pushtuesit njëshekullor, domethënë midis shqiptarëve si të pushtuar dhe serbëve si pushtues të Kosovës gjatë, gati një shekulli, nuk bëhet dialog, por bëhen bisedime, bisedime zyrtare, shtetërore, politike e diplomatike. Për çështje madhore siç janë liria e pavarësia, siç janë kufijtë, siç është mëvetësia e shtetit nuk bëhet dialog po bëhen bisedime zyrtare, shtetërore, politike e diplomatike. E shkencore. E jo dialogë. Duke i quajtur dialog e jo bisedime, bisedimet zyrtare, shtetërore mes shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë pjesëmarrësit e Kosovës në atë dialog në thelb po e degradojnë statusin shtetëror të Kosovës! Edhe në qoftë se një emërtim i tillë - dialog i bisedimeve u kërkohet prej tjetërkujt ata nuk do të duhej ta pranojnë!

2. Do të duhej të dihej se prej Kongresit të Berlinit, në të cilin do të vendosej rend i ri botëror, para së gjithash evropian, fizionominë politike e shtetërore të Ballkanit e përcaktonte fuqitë e mëdha evropiane: Britania e Madhe, Franca, Rusia, Gjermania, Italia. Prej Konferencës së Paqes në Paris në vitin 1919 në përcaktimin e fizionomisë politike e shtetërore të Ballkanit do të marrin pjesë me rol vendimtar edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjithashtu do të duhej të dihej se fuqitë e mëdha, varësisht prej rastit e çastit, kur më pak e kur më shumë i kanë lëvizur dhe mund t'i lëvizin parimet e kriteret në bazë të të cilave e kanë caktuar dhe mund ta caktojnë fizionominë politikë e shtetërore të Ballkanit a hapësirave të tjera.

3. Fuqitë e mëdha politike dhe botërore, me institucionet e sotme botërore të mbisunduara prej tyre, tashmë gjithnjë e më shpesh të quajtura faktorë ndërkombëtarë, kur më drejtpërdrejt e kur më ndërmjetueshëm i mbikëqyrin apo, madje, i përcaktojnë bisedimet midis popujve e shteteve të konfliktuara, apo të papajtuara, që ende nuk i kanë zgjidhur të gjitha çështjet e tyre politike e shtetërore. Këta faktorë zakonisht nuk lejojnë që në bisedimet e mbikëqyrura apo, madje, të përcaktuara prej tyre njërës palë t'i dhurohen të gjitha, kurse tjetrës asgjë! Ato kur më pak e kur më shumë kujdesen, herë sinqerisht e herë trekatërfytyrshëm, që ato bisedime të sjellin zgjidhje të baraspeshuara midis tyre.

4. Fuqitë e mëdha botërore, në të vërtetë faktorët ndërkombëtarë që i mbikëqyrin apo, madje, i përcaktojnë ato bisedime midis popujve e shteteve, zakonisht, nuk e kundërshtojnë fushas marrëveshjen që në mënyrë paqësore e arrijnë dy palët në bisedime dhe nuk e kundërshtojnë ashtu edhe në qoftë se ajo marrëveshje arrihet në sajë të disa zgjidhjeve që nuk janë në pajtim me ndonjë parim të politikës së tyre ndërkombëtare, siç janë, fjala vjen, korrigjimi i kufijve, lëvizja e kufijve, shkëmbimi i territoreve, apo, madje, siç ka ndodhur mes dy luftërave botërore, zhvendosja vullnetare e pjesëve të popullsisë. Veprojnë kështu faktorët ndërkombëtarë në radhë të parë për arsye se mospajtimi me marrëveshjen që e arrijnë në mënyrë paqësore dy popuj, dy shtete, do të thotë përzierje në

# TERRITOREVE

punët e tyre të brendshme, në të vërtetë cenim i sovranitetit të tyre politik e shtetëror, që, megjithatë, siç po shohim orë e çast në Kosovë, e cenonjë me heshtje e brohoritje!

5. Në bisedimet zyrtare shtetërore, politike e diplomatike midis dy popujve, dy shteteve, siç janë bisedimet e sotme midis Kosovës dhe Serbisë për çështje madhore politike e kombëtare zakonisht nuk shkohet me mendje dogmatike, nuk shkohet me një qëndrim. Në bisedimet për çështje të tilla madhore zakonisht shkohet me dy versione të të njëjtit qëndrim apo, madje, edhe me një qëndrim të quajtur alternativ. Përfaqësuesit e Kosovës në bisedimet e tanishme me përfaqësuesit e Serbisë e mohojnë pothuaj plotësisht këtë praktikë dhe e mohojnë sepse nuk e njohin a nuk duan ta njohin përvojën e shteteve me tradita të mëdha shtetërore, diplomatike, bisedimore në përgjithësi.

6. Në bisedimet zyrtare, shtetërore, politike e diplomatike, midis popujve e shteteve, siç janë bisedimet për çështje madhore mes Kosovës dhe Serbisë, zakonisht nuk flitet me kategori folklorike e romantike dhe nuk flitet me kategori të tilla sepse ato janë kategori të fëmijërisë së kulturës politike e shtetërore. E përfaqësuesit e Kosovës në bisedimet zyrtare, shtetërore, politike, me përfaqësuesit e Serbisë dhe të shteteve të tjera ndodh të flasin pikërisht me kategoritë e tilla! Paraqitjet e tyre politike romantike e folklorike të shpesh të herëve përmbajnë qëllimin e mashtrimit të opinionit vendor. Romantizmi dhe folklorizmi i tyre bëhet trumbetues posaçërisht pas cikleve të bisedimeve kur duan ta bëjnë me dije opinionin vendor për sukseset e tyre të sotme e të ardhshme bisedimore. Në raste të këtilla ata u thonë dëgjuesve të tyre se marrëveshja me Serbinë doemos do t'i sjellë Kosovës vendin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, thuajse pajtimi i Serbisë për t'u bërë shteti i Kosovës anëtar në OKB na qenka më i rëndësishëm se njohja prej 115 shteteve! Ata nuk e dinë apo nuk duan ta dinë se vendi i Kosovës në OKB më shumë se prej kujtdo tjetër varet prej pajtimit të Rusisë dhe të Kinës, të cilat kanë të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit të kësaj organizate.

Edhe më trumbetueshëm ky folklorizëm politik shprehet në deklaratat aq shpesh të përsërit-

ura për bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën pa treguar se ky bashkim mund të realizohet vetëm duke iu dhënë Serbisë pjesë e Veriut të Kosovës me shumicën serbe. Është politikisht dhe moralisht e palejueshme të mashtrohet dhe të nënçmohet mendja jonë politike me deklaratat të këtilla diletante mashtruese!

7. Në bisedimet zyrtare, shtetërore, politike e diplomatike midis popujve e shteteve, siç janë bisedimet e tanishme midis Kosovës dhe Serbisë, zakonisht duhet të njihet në tërësi jetëshkrimi politik i pjesëmarrësve, në mënyrë të veçantë, i kryepjesëmarrësit të palës tjetër në këto bisedime. Po të pajiseshin me të dhënat e duhura prej fillimit të bisedimeve për jetëshkrimin politik të kryepërfaqësuesit të Serbisë në bisedime, Aleksandër Vuçiqit, përfaqësuesit e Kosovës do të duhej ta "kushtëzonin" pjesëmarrjen në bisedime me largimin e tij. Dhe, do të duhej ta "kushtëzonin" pjesëmarrjen e tyre në bisedime me largimin e tij për shkak se ai ishte zyrtar i lartë në Partinë Radikale Serbe si parti shoviniste e Vojislav Sheshelit, për shkak se ai ishte zyrtar i lartë në Qeverinë e Millosheviqit, e cila, përpos të tjerash, ka bërë dhe zhvendosjen e dhunshme të gati gjysmës së shqiptarëve të Kosovës në gjysmën e parë të vitit 1999, për shkak se ai ishte i thhtar i qëndrimit politik, partiak e shtetëror të Vojislav Sheshelit për dëbimin e shqiptarëve përtej Bjeshkëve të Nemuna dhe, më në fund, për shkak se ai ishte bashkëveprues politik në gjenocidin e Srebrenicës ndaj myslimanëve të Bosnjës. Mbas deklaratës zyrtare të Qeverisë së Serbisë në të cilën thuhej se delegacioni serb nuk i pranonte bisedimet me delegacionin shqiptar të kryesuar prej nënkryeministrit të Kosovës, Fatmir Limaj, pjesëmarrja e përfaqësuesve të Kosovës në ato bisedime me delegacionin serb të kryesuar prej Aleksandër Vuçiqit bëhet plotësisht e palejueshme politikisht, moralisht dhe kombëtarisht.

8. Përfaqësuesit e Kosovës në bisedimet e tanishme me përfaqësuesit e Serbisë do të duhet ta dinë se, siç na mëson historia, asnjë rend botëror s'është i gjithmonshëm: çdo rend botëror më herët a më vonë zëvendësohet prej një rendi tjetër botëror. Rendi i sotëm botëror, i bazuar në të drejtat e njeriut, është rend

botëror si i dhuruar prej Perëndisë për ne shqiptarët. Por nuk do të duhej të harrojmë se edhe ky rend botëror do të ketë një fund dhe dikur do të jetë i zëvendësuar prej një rendi tjetër botëror. Mjerisht askush prej nesh sot s'mund ta thotë me siguri nëse ai rend tjetër botëror do të jetë i fatshëm a fatkeq për ne. Por ne, si popull, si popull tani me dy shtete nuk guxojmë të mos mendojmë edhe për këtë mundësi të dytë.

9. Përfaqësuesit e Kosovës në bisedimet e tanishme me përfaqësuesit e Serbisë do të duhej të dinë se edhe më tej, shumë, shumë serbë, në të vërtetë, numri më i madh i tyre, besojnë në mitologjinë mesjetare serbe. Ata besojnë se historia e Kishës Pravoslave Serbë në Kosovë është histori 800-vjeçare! Ata besojnë se Prizreni ishte kryeqyteti i Perandorisë së Car Dushanit! Ata besojnë se Kosova është burimi shpirtëror i serbëve! Ata besojnë se Kosova me historinë dhe traditat e saj përcakton identitetin shpirtëror serb! Kjo pseudomitologji është përmbajtje e shkrimeve të një vargu studiuesish, shkrimtarësh e intelektualësh të tjerë serbë sot, që kundërshtojnë me gjuhë gjoja shkencore, në të vërtetë euforike, çdo ide për pajtimin me shkëmbim territoresh e me pavarësinë e Kosovës. Ata e përsërisin mendimin e kryetarit të dikurshëm grek Karamanlis, i cili në një rast i paska thënë Dobrica Qosiqit: "Asgjë s'mund të bëni sot për Kosovën sepse të gjithë janë kundër jush; duhet të prisni kohë tjetër që doemos do të vijë!"

Mund të supozohet se informimi i përfaqësuesve të Kosovës në bisedimet zyrtare, shtetërore, politike e diplomatike, me përfaqësuesit e Serbisë në Bruksel për idetë dhe domethëniet politike, diplomatike, shtetërore të përmbajtura në pikat e sipërthëna nuk do të ishte i pafrytshëm për ta. Nuk ka dyshim se shpjegimet e sipërthëna sjellin bindjen se shkëmbimi i territoreve s'do parë e trajtuar siç po e trajtojnë kundërshtarët e tij.

Nuk e quaj mençuri zgjidhjen e hamendësuar të konfliktit të gjatë historik shqiptaro-serb me arnime të përkohshme! E quaj mençuri politike e historike zgjidhjen e këtij konflikti me zgjidhje të përhershme, me zgjidhje historike, që nënkupton shkëmbimi i territoreve, i shfaqur si gjasë pothuaj e papritur sot, për brezin tonë. Dijet që janë mbledhur në

mendimoren tonë kombëtare për historinë e çështjes së Kosovës dhe çështjes shqiptare në përgjithësi, dijet që janë mbledhur në mendimoren tonë kombëtare për historinë e Serbisë e për pseudomitologjinë e saj mesjetare që, megjithatë, përbën përcaktuesin e gjendjes shpirtërore e kulturore serbe, dijet që do të duhej të kishim për rolin e Kishës Pravoslave Serbe në politikën dhe në jetën kombëtare, shtetërore, politike e kulturore serbe gjatë historisë e sot dhe, pashmangshëm, mendimet e pandalshme që ne, brezi i sotëm, duhet t'i kemi për ardhmërinë e qetë dhe të sigurt të pasardhësve tonë, pa dhembjet e tragjeditë tona të deritanishme - të gjitha këto më bëjnë të besoj se shkëmbimi i territoreve: i Veriut të Mitrovicës, natyrisht, pa objektet vitale për zhvillimin e Kosovës, me Luginën e Preshevës (Preshevë, Bujanoc e Medvegjë) do të ishte zgjidhja politike, shtetërore e kombëtare, domethënë do të ishte zgjidhja historike e çështjes së marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë.

Të përsëris, brezi ynë i sotëm s'ka të drejtë morale të mendojë për përfundimin e bisedimeve me Serbinë pa menduar për ardhmërinë e pasardhësve tonë. E do të mendojmë si duhet për ardhmërinë e pasardhësve tonë në qoftë se do ta kemi në mendje atë urtësinë e mendimtarit të madh evropian i cili ka thënë: "Shteti është bashkëpronë e të gjallëve, e të vdekurve dhe e të palindurve ende". Domethënë: Shteti është i atyre që kanë jetuar por nuk janë më të gjallë, i atyre që sot jetojnë në të dhe i atyre që do të jetojnë pas nesh në të, domethënë i pasardhësve tonë.

Tradita politike e historike jo vetëm evropiane dhe mendimi i menduar historik, objektiv, na thonë se nuk është shkëmbimi i territoreve, në këtë mes i territoreve të sipërthënë, i arritur në mënyrë paqësore, me marrëveshje midis dy palëve, çështje që sjell luftë. Jo. Dhe, jo. Marrëveshjet paqësore, që arrihen me marrëveshje midis palëve në konflikt apo ende të papajtuara, nuk sjellin luftë; luftë mund të sjellin marrëveshjet e pranuar nën trysni: nën trysninë e faktorëve të brendshëm apo të jashtëm.

Shkëmbimi i territoreve të sipërthëna midis Kosovës dhe Serbisë do të mënjanonte prej së tashme së Kosovës të gjitha ato kërkesa dhe pengesa të Serbisë dhe të strukturave serbe

në Kosovë, që po e pengojnë Kosovën të bëhet shtet funksional.

Shkëmbimi i territoreve të sipërthëna do të mënjanonte prej historisë së Kosovës dhe historisë shqiptare në përgjithësi të papriturat e mundshme, kur më pak e kur më shumë kundërvepruese, që përmban Bashkësia e Komunave Serbe në Kosovë, që me politikën dhe me veprimtarinë e saj, të paraparë e të papraparë, përbën faktorin e forcimit të rolit të serbëve në Kosovë, e përmes tyre të forcimit të rolit politik edhe të Serbisë në Kosovë e në rajon - të forcimit me përbërje e qëllime të paparashikueshme prej strukturave politike e shtetërore të Kosovës sot!

Rrjedhimisht shkëmbimi i territoreve në mënyrë paqësore, me Marrëveshje, midis Kosovës dhe Serbisë mund të shpresohet, e përsëris, mund të shpresohet, sado kurrë me siguri të qindpërqindtë, se sjell paqe midis këtyre shteteve dhe popujve të tyre, paqe të përtashme dhe paqe historike. Marrëveshja e tillë, e realizuar me shkëmbim të territoreve, realisht do të duhej ta bënte të pamundshme, me të gjitha pikëpamjet të pamundshme, rilindjen, në të vërtetë vampirizimin e pasojave të pseudomitologjisë serbe në Kosovë. Kjo, ndërkaq, nuk mund të thuhet për marrëveshje të tjera, të arritura me arnime, me pajtime e ç'pajtime të tjera!

Nuk mund të mos supozohet sado pak, ndërkaq, se roli i tillë historik i shkëmbimit të territoreve e ka shtuar numrin e zyrtarëve të sotëm dhe të mëparshëm politikë e shtetërorë në SHBA-të dhe në BE-në dhe në disa vende të tjera, që janë shprehur në favor të shkëmbimit të territoreve mes Kosovës e Serbisë.

Dhe, në fund, le të thuhet haptas e qartë edhe ky mendim që mund t'i hidhërojë feudalët politikë e intelektualë në Kosovë sot:

Shkëmbimi i territoreve të sipërthëna, i arritur në paqe, me Marrëveshje midis shqiptarëve dhe serbëve, me pajtimin në fund të faktorëve ndërkombëtarë, me pajtimin e SHBA-së dhe të BE-së, do ta bënte më të madhe se ç'është sot mundësinë politike, kombëtare e ndërkombëtare, për zgjidhjen përfundimtare, historike, të çështjes së Kosovës: për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Ashtu qoftë!

## Trumpi dhe Erdogani diskutojnë tensionet në Detin e Zi

WASHINGTON, 29 NËNTOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, bisedoi përmes telefonit me presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, rreth konfrontimit detar midis Rusisë dhe Ukrainës, tha zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders. Rusia ka aneksuar tri anije të Ukrainës dhe ka arrestuar ekuipazhin e saj në brigjet

jashtë Krimesë, duke thënë se ato kanë kaluar ilegalisht në ujërat e saj. Paraprakisht, ajo ka hapur zjarr, duke plagosur gjashtë ukrainas. Ukraina ka shpallur gjendje lufte në disa zona të vendit. "Dy liderët shprehën shqetësim të thellë për incidentin në Ngushticën Kërç dhe për mbajtjen e vazhdueshme të anijeve dhe anëtarëve të ekuipazhit të Ukrainës", tha

përmes një deklaratë Sanders. Erdogani tha se ka biseduar në telefon edhe me presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, edhe me presidentin e Ukrainës, Petro Poroshenko. "Në bisedën time me Putinin, temë kryesore ishte situata që po vazhdon me Ukrainën. A mund të shërbejmë në rolin e ndërmjetësit? E kemi diskutuar këtë çështje me të dyja palët", tha Erdogani.



## Nancy Pelosi shpreson të rizgjidhet kryetare e Dhomës së Përfaqësuesve

Nëse konfirmohet në janar, Nancy Pelosi nga Kalifornia nuk do të jetë vetëm kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, por edhe një grua që e ka mbajtur këtë post dy herë

WASHINGTON, 29 NËNTOR - Nancy Pelosi, një demokrate nga Kalifornia, u propozua të mërkurën për kryetare të Dhomës së Përfaqësuesve. Nëse konfirmohet në janar, ajo nuk do të jetë vetëm kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, por edhe një grua që e ka mbajtur këtë post dy herë. Pelosi nuk kishte rivalë dhe fitoi lehtësisht, pavarësisht nga kundërshtarët e partisë së saj, të cilët preferonin një udhëheqje të re.

Demokratët votuan me shumicë dërrmuese për të emëruar Pelosi si kryetare të Dhomës së Përfaqësuesve për herë të dytë. Ligjvënësja më e lartë amerikane është e bindur për fitore kur ajo të përballlet me një votim të plotë në Dhomën e Përfaqësuesve më 3 janar.

Pak njerëz, mund të venë në pikëpyetje përvojën, njohuritë apo aftësitë politike të Pelosi. Por shumë besojnë se është koha për të sjellë drejtues të rinj me ide të reja. Pelosi është 78 vjeç. "Kur sheh udhëheqjen e demokratëve në Dhomën e Përfaqësuesve, duket sikur është

komiteti koordinues i një azili pleqsh, të gjithë janë afër të 80-tave. Ku është brezi i ri i demokratëve? Ata nuk do t'i drejtojnë demokratët të marrin pushtetin me një ekip drejtues të tillë", thotë Larry Sabato nga Qendra për Politikën.

Kur demokratët të bëhen shumicë në Dhomën e Përfaqësuesve vitin e ardhshëm, pritet që të kërkojnë hetimin e presidentit Donald Trump, përfshirë fushatën e tij presidenciale, marrëdhëniet e tij të biznesit dhe deklarimin e taksave. Pelosi do t'i kryesojë këto përpjekje. "Detyra jonë është të sigurojmë kontrollin dhe balancën ndaj presidentit dhe degëve të tjera të qeverisjes dhe do ta bëjmë këtë me dinjitet", tha Pelosi.

Presidenti ka qenë kritik ndaj Pelosi në fushatat e fundit në emër të kandidatëve republikanë për në Kongres. Por ai shprehu mbështetje për garën e saj për t'u bërë kryetare e Dhomës së Përfaqësuesve. "Nëse ajo ka nevojë, mendoj se do të jem në gjendje që t'i siguroj shumë vota të nevojshme. Nuk



kam asnjë synim tjetër përveçse me të vërtetë besoj se ajo e meriton atë pozitë. Unë gjithashtu besoj se Nancy Pelosi dhe unë mund të punojmë së bashku

dhe të bëjmë shumë gjëra", tha presidenti Trump.

Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve është politikani i tretë më i lartë në Shtetet e

Bashkuara pas presidentit dhe nënpresidentit. Duke e mbajtur atë pozitë, Pelosi është politika- nia më e lartë femër në historinë e Shteteve të Bashkuara.

## Seehofer: Myslimanët janë pjesë e Gjermanisë

BERLIN, 29 NËNTOR - Ministri i Brendshëm gjerman, Horst Seehofer deklaroi se "myslimanët janë pjesë e Gjermanisë", gjatë ditës së parë të Konferencës së Islamit në Gjermani.

Deklaratën e ministrit kristiansocial të Punëve të Brendshme Horst Seehofer, se "myslimanët janë pjesë e Gjermanisë" disa e konsideruan një kthesë 360 shkallë, ndërsa disa të tjerë e panë në një këndvështrim më pak dramatik.

Horst Seehofer u shpreh të mërkurën në Berlin se "myslimanët i përkasin Gjermanisë", teksa drejtoi Konferencën e

katërt Islame Gjermane (DIK). Deklaratat e tij tërhoqën vëmendje të veçantë, duke pasur parasysh deklaratat e së shkuarës të Seehofer, kur thoshte se "Islami nuk është pjesë e Gjermanisë".

Në deklaratat e fundit Seehofer tha se myslimanët kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime si të gjithë qytetarët e këtij vendi. "Nuk mund të ketë dyshime rreth kësaj çështjeje", tha ai. Seehofer, i cili u la mënjanë si udhëheqës i Unionit Kristian Social (CSU) në Bavari, ngjalli debate gjatë muajit mars, kur deklaroi se "Islami nuk i përket Gjermanisë" dhe se "Gjermania është formësuar nga

Krishtërimi".

Gjithsesi, edhe gjatë asaj interviste aq të lexuar të muajit mars dhënë për "Bild", Seehofer pati deklaruar se: "myslimanët që jetojnë këtu janë pjesë natyrale e Gjermanisë. Kjo, sigurisht që nuk nënkupton se ne do të heqim dorë nga traditat dhe zakonet e veçanta të vendit tonë kundrejt deklaratimeve false". Këto komente nxitën kritika të ashpra ndaj Seehofer, dhe shumë menduan se deklaratat e fundit u bënë për të zbutur ato të mëparshmet.


Konferenca Islame Gjermane, e cila për herë të parë u mbajt në vitin 2006 nga ish-ministri i Brendshëm Wolfgang Schäuble,



mbledh së bashku myslimanë gjermanë dhe zyrtarë të qeverive të landeve dhe të asaj federale. Qëllimi i kësaj Konference është të përmirësojë pjesëmarrjen

fetare dhe shoqërore të mysli- manëve në Gjermani dhe të zhvillojë më tej dialogun mes përfaqësuesve shtetërore dhe organizatave Islamike.

# PËRMASAT E FILMIT 'SKËNDERBEU'



Shkruan: Jakup  
KRASNIQI

28 Nëntorin e sivjetmë, mbase për të parën herë të aktivitetit tim politik në liri, e prita në shtëpi me familje. E shfrytëzoza këtë rast dhuntie dhe kohe për të rishikuar nga fillimi e në mbarim kryeveprën artistike për Skënderbeun, filmin "Skënderbeu", prodhim i kinostudios "Shqipëria e Re". Ndoshta për herë të parë nuk e shikova si vepër arti, si vepër kulture apo thjesht si vepër historike që lartëson një epokë të

veçantë për shqiptaro- arbërorët dhe prijësin e përmasave të paarrishme planetare - Skënderbeun! Një lavdie shkuar lavdie skënderbegiane. Shkurt, në film rishikova gjithë historinë e arbërorëve të kohës e më vonë të etnisë shqiptare, që formoi krahas kombeve të tjera të shekullit XIX edhe kombin shqiptar, falë periudhës së artë - Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Pikërisht kjo më shtyri, më shumë se kurdoherë tjetër, që ta shoh filmin edhe në një kënd tjetër, në këndin e përmasës së vërtetë të këtij filmi historik e artistik, ta shoh gjithë historinë e kombit tim. Pa dyshim se këtë ndjenjë ta jep një vepër që është krijesë e mendjes së urtë e parashikuese e një brezi të madh artistësh dhe intelektualësh, të cilët u formësuan, u idealizuan për t'i dhënë

shkëlqim historisë e ardhmërisë. Natyrisht, për mendjen dhe urtinë njerëzore kurrë më shumë se sot nuk kemi pasur nevojë, prandaj duhet t'u jemi falënderues. Një mirënjohje të veçantë duhet ta kemi në radhë të parë për regjisorin e skenaristin e filmit, por edhe për çdonjërin që në një formë apo tjetër ka dhanë kontributin për të jetësuar jo vetëm historinë e Kastriotit, komandantit më të madh të shekujve në rrafshin global, por edhe të gjithë historisë së kombit tonë.

Nëse filmi shikohet me kujdes nga fillimi deri në fund, zhvillimin horizontal dhe atë vertikal, linjat dhe sekuencat, karakteret dhe planet qoftë nga enterieri, qoftë eksterieri, dialogët, fotografia etj., njeriu ka mundësi të mësojë historinë e shqiptarëve prej kohërave më

të hershme e deri te kjo e ditëve tona. Mëson për urtinë e trimërinë, për lavdinë e tragjedinë, mëson për armiqësitë e tradhtitë, për besën e pabesinë, për dashurinë e ligësitë e natyrës njerëzore, të njerëzve të Evropës së kohës dhe reflektimi në këtë të sotshmen. Ashtu siç ishin dje këto virtyte e vese (karakteret) të njerëzve të kohës, sot janë të pranishme më shumë se kurrë.

Gjithsesi kohës sonë, momentumit, më shumë se kurrë i duhet virtyti skënderbegian për të cilin ka folur dhe e ka kërkuar aq shumë vetë kryeheroi ynë nga bashkëkohësit e vet dhe rrjedhimisht edhe pasardhësit, popullin shqiptar!

Për virtytin, sipas Barletit, Skënderbeu thoshte:

"Virtyti më i lartë dhe besa e vërtetë, o princër fort bujarë dhe ju, o bashkëluftëtarë të mi

shumë të dashur, kujtoj se është së pari të adhurosh, të kesh kujdes e të nderosh si duhet, me shpirt të pastër e me frikë perëndie në zemër, Zotin e madh e të vërtetë. Së dyti, jo vetëm ta duash dhe ta kesh gjithmonë para syve atdheun dhe shtetin, ku secili ka lindur e është edukuar, por edhe ta mbrosh e ta shpëtosh edhe me gjak".

Nga kjo del se vetëm njerëzit e virtytshëm e me integritet, si dje edhe sot e kanë guximin atdheut t'i dalin zot sa herë që kërkohet.

Shkurt, e gjithë historia e lavdishme e kombit tonë tregon se nuk mund të ketë dashuri shenjtërore aty ku mungon virtyti (dija thoshte Sokrati), mungon dinjiteti, integriteti e guximi për t'i hapur shtigjet e lirisë e jetësuar lirinë!

## SKICË PËR BASHKIMIN KOMBËTAR

### Historia, mësuesja e bashkimit kombëtar

- O sot, o kurrë: Historia mësuesja e jetës

Shkruan: Ismail  
GASHI-SILLOVIA

Janë të shumtë shembujt, ngjarjet dhe kohët pozitive nga historia jonë e lavdishme, që janë aktuale dhe duhet të na shërbejnë për udhëzues edhe sot, në veprimet e përbashkëta politike, shtetërore e kombëtare drejt bashkimit kombëtar.

Kuvendi i Lezhës 1444 duhet të na shërbejë shembull modeli për unitet kombëtar, sepse në këtë Kuvend morën pjesë të gjitha principatat e atëhershme shqiptare të arbrit dhe pa asnjë kundërshtim, zgjodhën Gjergj Kastriotin Skënderbeun kryetrim të luftës së përbashkët kundër robërisë osmane, dhe Krujën e zgjodhën kryeqendër të rezistencës shqiptare.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878 është një ndër ngjarjet më të rëndësishme të historisë kombëtare, të cilin e diktuan rrethanat, tuboi në një gjuhë e një flamur, përfaqësuesit nga gjitha hapësirat dhe besimet fetare shqiptare në Prizren, për mbrojtjen dhe çlirimin e atdheut dhe lirinë e popullit nga sundimi osman.

Kongresi i Manastirit më 1908, ngjarje e lavdishme për identitet kombëtar, që dëshmon se, shqiptarët kishin aspiratë jo vetëm çlirimin e atdheut e lirinë kombëtare, por kishin synim edhe bashkimin kombëtar. Në këtë Kongres marrin pjesë delegatët intelektualët atdhetarë, krijuesit dhe veprimtarët e çështjes kombëtare nga të

gjitha hapësirat etnike shqiptare. Për zgjedhjen e alfabetit të përbashkët të gjuhës kombëtare shqiptare. Karakteristikë e veçantë ishte se pjesëmarrësit e Kongresit ishin nga të gjitha besimet fetare dhe vendosen që, shkronjat për gjuhën shqipe, krijimet shpirtërore shqiptare, të shkruhen me shenja grafike, shkronja latine, që ishte përcaktim në drejtim perëndimor-latin, duke u ndarë nga dy krahet lindorë, lindjes osmane-arabaturke dhe lindjes ortodokse-grekosllave.

Kongresi i Manastirit për katër vjet i priu shpalljes së Pavarësisë së shtetit shqiptar në Vlorë më 28 nëntor 1912. Kur shqiptarët e përbashkuar, të prirë nga plaku mjekërbardhë, Ismail Qemali, ngritën flamurin kombëtar në Vlorën heroike. Pavarësia shqiptare ishte për të gjithë shqiptarët dhe për të gjitha trojet shqiptare. Ishte, siç e pat thënë i madhi Isa Buletini, udhëheqësi i gardës dhe mbrojtësi në Kuvendin e Lezhës dhe Ismail Qemalit, "Shqipëria është gjithandëj ku bukës i thonë bukë e ujit i thonë ujë".

Ndërsa ngjarje madhore që i kurorëzoi aspiratat shekullore për njësimin e gjuhës shqipe, me një unitet të paparashikuar, kur marrim rrethanat dhe pozitën e shkapërderdhur të shqiptarëve në disa shtete, më 1972 në Tiranë, u arrit mbajtja e Kongresit për njësimin e gjuhës letrare shqiptare. Në këtë Kongres, duke llogaritur parapërgatitjet e gjata në hapësirat shqiptare jashtë

Shqipërisë, si Konsulta e gjuhës shqipe e vitit 1968 në Prishtinë. Pjesëmarrësit, shkencëtarë gjuhëtarë, publicistë, letrarë dhe intelektualë krijuar e artistë, pas disa ditësh diskutimi e trajtimi shkencor e kombëtar, pa asnjë kundërshtim, arritën qëllimin e madh historik e kombëtar, njësimin e gjuhës letrare kombëtare.

Këta shembuj, këtu vetëm të zënë në gojë, si edhe shumë ngjarje e kohë të tjera në historinë tonë të lavdishme, sot veprimet demokratike në dy shtetet shqiptare dhe hapësirat etnike

shqiptare, jashtë kufijve të Shqipërisë dhe Kosovës, patjetër duhet të marrin për mësim e t'i mbështesin për mësim të historisë e mësim nga mësuesi ynë i madh - populli, të shërbejë për një ndryshim e veprim pozitiv politik, moral dhe kombëtar. Ne shqiptarët, klasat politike dhe institucionet shtetërore shqiptare. Aktualisht qeveritë e shteteve shqiptare, andej e këndeje Drini, domosdo duhet të largojnë e të largohen nga shëmnia tradicionale e përçarjes. Të ndërrojnë formën dhe mënyrën e veprimit të qeverisjes në drejtim të për-

bashkimit, mrekullisë monumentale kombëtare kur është interesi kombëtar dhe shtetëror. Përçarja është shëmnia jonë tradicionale që na ka përcjellë e na ka dëmtuar më shumë se pushtuesit dhe armiqtë tanë historikë e që, për fat të keq, edhe në kohët tona të demokracisë po na përcjellin. Shëmnia është futur, si mish dhe, jo vetëm në qeniet tona personale, por është bërë pjesë e dukuri e moralit tonë politik në jetën sonë politike, shtetërore dhe kombëtare.


Atdheu mbi të gjitha!  
Shqipëria e shqiptarët.



**E jashtëzakonshme**

## Zbulohet në Izrael maska 9.000-vjeçare prej guri

Një maskë guri nga periudha neolitike u zbulua në rajonin e Pnei Hever në Izrael. Maska daton 9.000 vjet më parë dhe mendohet të jetë përdorur në ritualin e adhurimit të paraardhësve. Ajo u gjet disa muaj më parë, por lajmi nuk ishte zbuluar deri tani. E bërë nga guri gëlqeror ngjyrë rozë dhe të verdhë, maska formoi me kujdes një fytyrë njerëzore, me sy, hundë dhe buzë.



**FOTO E DITES**



Punëtorët tërheqin një cisternë me një litar në lumin Ganges në Indi. /AP/

**E rrallë**

## Moti i keq në Zelandën e Re nxjerr në breg skeletin e një kafshe misterioze

Në rrjetin social "Facebook" është lëshuar një apel nga gazetari Chris Lynch: "Kush mund të më ndihmojë ta identifikoj këtë krijesë?" Kërkesa e pazakontë u shoqërua



me fotografi të ndryshme që tregojnë një krijesë të papërcaktuar dhe me pamje të dyshimtë, e cila ka dalë në plazhin e Canterbury, në Zelandën e Re.

## BARSOLETA E DITËS



Dy shokë:

- Ja ku i ke 100 euro që t'i kam pasur borxh.
- 200 euro more t'i kam dhënë.
- Po sot është 'Blackfriday'!




### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### “ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

#### “JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.

Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

#### “NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.

Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

#### “SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.

Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

#### “VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.

Regjia: Ruben Fleischer

Based on the Marvel Comics



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




**DASHI**

Çdo gjë po ecën siç e kishit programuar, por ndonjë ndryshim programi ndonjëherë është i nevojshëm.



**DEMI**

Jeni gjithmonë shumë të stresuar kur keni disa gjëra njëkohësisht për të zgjidhur. Sot do të tentoni të kërkonit ndihmë të personat që nuk i njihnit.



**BINJAKËT**

Mos u shtirni sikur gjithçka po shkon mirë. Në të përditshmen tuaj ka shumë probleme dhe duhet të gjeni një zgjidhje sot.



**GAFORRJA**

Sot duhet të anashkaloni gjithçka dhe t'i kushtoni kohë partnerit. Një problem i tiji do të marrë të gjithë vëmendjen tuaj.



**LUANI**

Puna është pikësynimi kryesor sot dhe ju jeni duke dhënë gjithçka nga vetja për të arritur objektiva tuaja në ambientin e punës.



**VIRGJËRSHA**

Ju i keni përgjigjet për një problem që i ka dalë një mikut tuaj. Mundohuni t'i jepni sa më shpejt zgjidhjet që i ofroni.



**PESHORJA**

Njerëzit ndihen shumë të sigurt kur ju kanë ju pranë. Mundohuni ta shfrytëzoni këtë siguri për ta ngjallur bashkëpunimin me njëri-tjetrin.



**AKREPI**

Edhe pse ju duket se po kërkojnë shumë nga ju sot, mbase gaboheni. E vetmja gjë që po ju kërkohet është pak më shumë sinqeritet në marrëdhënie.



**SHIGJETARI**

Nëse sot do t'ju duhet të sqaroni disa dyshime duhet të përballemi. Nëse ikni dhe fshiheni do të krijoni një marrëdhënie të cunguar.



**BRICJAPI**

Sot do ta kënaqni kuriozitetin e një mikut tuaj duke i treguar një sekret tuajin. Priten lajme të reja sa i përket karrierës.



**UJORI**

Duhet të diskutoni herë pas here dhe t'i ndani opinionet tuaja me partnerin. Pasditja do të kalojë e qetë dhe pa ndonjë angazhim.



**PESHQIT**

Keni kuptuar që komunikimi është mjeti më i mirë për të qenë korrekt me të tjerët. Në një çështje pune bëni mirë t'i diskutoni të gjitha opsionet.

## Katie Holmes drejt altarit, së shpejti dasma në Paris



**K**atie Holmes dhe Jamie Foxx pritet të martohen në Paris. Prej vitesh ata e mbajnë të fshehtë lidhjen tyre dhe duket se më në fund dashuria e tyre do të kurorëzohet. 39-vjeçarja dhe 50-vjeçari po planifikojnë të lidhin kurorë në "City of Lights" (qytetin e


dritave), në kryeqytetin francez. "Parisi është qyteti ku ata kanë vendosur të dalin publikisht me lidhjen e tyre, pas shumë vitesh që e kanë mbajtur sekret", ka thënë ky burim. Çifti ka nisur lidhjen në vitin 2013, vetëm një vit pasi aktorja Holmes i dha fund martesës me Tom Cruise.

## Leonardo DiCaprio së shpejti mund të martohet



**L**eonardo DiCaprio së shpejti mund të mos jetë më beqar. Ai dhe e dashura e tij, Camila Morrone, mund të martohen shumë shpejt. Një burim i afërt me çiftin ka thënë për revistën "Us Weekly" se lidhja e tyre po bëhet gjithnjë e më


serioze. "Të gjithë afër tyre thonë se martesë mund të ndodhë shumë shpejt", ka thënë ky burim. Modeluesja është 22 vjet më e re se aktori, por duket se kjo nuk po e pengon aspak lidhjen e tyre të dashurisë.



© WWW.MATRIXPICTURES.COM.AU

## Rita Orës erëra ia zbulon të pasmet

**K**ëngëtarja me prejardhje nga Kosova me famë botërore, Rita Ora, është zënë në befasi për shkak të motit të lig gjatë paraqitjes së saj në ndejën e fundit të Cartier në Sidnej. Erërat e forta bënë që fustani i saj t'i zbulonte pak pjesët e vitheve të saj, gjë e cila është kapur edhe nga syri i kamerave.



## Selena Gomez lanson koleksionin me 'Puma'-n

**K**ëngëtarja Selena Gomez ka lansuar koleksionin e parë të dizajnuar nga ajo, këtë e bëri në bashkëpunim me kompaninë 'Puma'. Koleksioni i saj u quajt "STRONG GIRL". Për këtë koleksion ajo për revistën "Elle" u shpreh se ndonjëherë kalon ulje dhe ngritje të çuditshme, por në përgjithësi tha se njerëzit duhet ta veshin atë që ndihen rehat.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

CARDIFF - WOLVERHAMPTON

2

DUNDEE UTD - AYR

1

REAL ZARAGOZA - CADIZ

3+

# Islami: Feronikeli synon daljen në Evropë

Përparim Islami për "Epokën e re" ka thënë se synimi i skuadrës së Feronikelit është dalja në Evropë, duke mos treguar se a e synon kjo skuadër edhe shpalljen kampione vjeshtore në IPKO Superligë. "Në Kupë jemi kualifikuar. Së bashku me pesëmbëdhjetë skuadrat e tjera shortin e presim të premten. Synimi ynë është dalja në Evropë si kampion ose si fitues të Kupës", ka thënë Islami



Dritës në stadiumin "Fadil Vokrri". "Prishtina është një pikë para nesh, por e zhvillon ndeshjen e radhës me Dritën që ka një ekip cilësor. Pozita në tabelë nuk është reale në krahasim me potencialin që ka kjo

skuadër. Ne jemi të fokusuar vetëm te rezultatet e skuadrës sonë", ka shtuar ai. Feronikeli është kualifikuar më tutje në garën e Kupës, pasi e ka mposhtur skuadrën e Trepçës me rezultat 1-2, kurse Islami

bën të ditur se skuadra nga Drenasi synim e ka triumfin në garën e Kupës ose për titull në mënyrë që ta sigurojë pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare. "Në Kupë jemi kualifikuar dhe së bashku me pesëmbëdhjetë skuadrat e tjera shortin e presim të premten. Synimi ynë është dalja në Evropa si kampion ose si fitues i Kupës", ka thënë Islami. I pyetur për rezultatet e ish-skuadrës së tij, Trepçës '89, Islami është përgjigjur: "Nuk më takon t'i komentoj rezultatet e ish-skuadrës, por vetëm kam dëshirë t'i uroj suksese. Kam respekt për të gjithë në këtë klub". Feronikeli renditet në pozitën e dytë me 36 pikë. Prej 16 ndeshjeve të zhvilluara, ka arritur njëmbëdhjetë fitore, tri barazime dhe dy humbje.

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Mbrojtësi i skuadrës së Feronikelit, Përparim Islami, ka folur para ndeshjes me Flamurtarin, e cila zhvillohet të shtunën në kuadër të javës së 17 në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Mbrojtësi i djathtë ka thënë se skuadra kuqezi nuk duhet të nënçmohet për faktin se i ka ndalur shumë skuadra

që pretendojnë titullin e kampione. "Ndeshjen e radhës e kemi me Flamurtarin. Assesi nuk bën ta nënvlerësojmë, sepse kjo skuadër ka shënuar rezultate pozitive. Ne jemi përgatitur maksimalisht për këtë ndeshje. Mungesa nuk kemi dhe shpresojmë se do ta japim maksimumin", ka thënë Islami, i cili nuk ka dhënë parashikim të saktë se a mund të dalë Feronikeli kampion vjeshtor, pasi Prishtina e pret skuadrën e

# Kryeministri Haradinaj: Xhudistët do të kenë kushte më të mira për punë

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka premtuar se shteti do t'i marrë përsipër obligimet karshi xhudistëve, të cilët e ngrehën flamurin e Kosovës në nivelet më të larta botërore të sportit. "Kosova ka shumë vajza dhe djem të suksesshëm që po na bëjnë krenarë kudo në botë. Xhudistët tanë kanë arritur kulmin me medalje botërore dhe evropiane. Ju me talentin tuaj dhe punën e palodhshme e ngrehët flamurin e Kosovës në nivelet më të larta botërore të sportit dhe për këtë ju jemi mirënjohës përjetë, siç do t'i marrim përsipër edhe obligimet tona si shtet karshi juve", ka thënë Haradinaj, pas takimit me kryetarin e Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka, trajnerin Driton Kuka dhe ekipin e xhudistëve, të përbërë nga Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Akil Gjakova, Loriana Kuka dhe Distria Krasniqi.



Kryeministri Haradinaj në emër të Qeverisë së Kosovës e ka përgëzuar ekipin e xhudos për arritjet e shumta, duke thënë se janë shembulli më i mirë për të rinjtë e tjerë se si duhet të punohet dhe të afirmohet vendi. "Ju jeni gjenerata e artë e vendit dhe normë olimpikë. Përkrahja për ju duhet të jetë e pakursyer dhe ne si Qeveri do të angazhohemi që, krahas infrastrukturës

ligjore për të cilën kemi punuar, ta avancojmë edhe infrastrukturën teknike që ju të keni kushte më të mira për të ushtruar", ka deklaruar Haradinaj. Ndërsa ekipi i xhudos e ka njoftuar kryeministrin Haradinaj për të gjitha sukseset e xhudistëve të Kosovës, duke thënë se ky ka qenë viti më i suksesshëm për ekipin e tyre, duke i fituar 21 medalje në garat e shumta ndërkombëtare. Ata kanë kërkuar nga Qeveria mbështetje institucionale për përmirësimin e kushteve të punës, për të cilën kërkesë kanë marrë mbështetjen e kryeministrit Haradinaj. "Është për admirim puna që po bën ekipi i trajnerit Kuka. Institucionet e vendit duhet të krijojnë kushte dhe hapësirën e duhur në mënyrë që të rinjtë tanë mund të përfshihen më shumë në sfera të ndryshme të jetës shoqërore", ka përfunduar Haradinaj.

# Kosova 'fluturon' në renditjen e FIFA-s

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka "fluturuar" në renditjen e FIFA-s. Suksesi historik i arritur në Ligën e Kombeve ka bërë që "Dardanët" të pozicionohen gjashtë pozita më lart, duke u pozicionuar në vendin e 131-t. Shqipëria nuk ka ndryshuar në renditjen e re të FIFA-s, pasi ende renditet në pozitën e 60. Belgjika është e para në renditje me vetëm një pikë më shumë se Franca. Në pozitën e tretë është Brazili, kurse në pozitën katër dhe pesë renditen Kroacia dhe Anglia. Në dhjetëshen më të mirë janë Portugalia, Uruguai, Zvicra, Spanja dhe Danimarka.



# "Epoka e re" për fitore edhe ndaj "KosovaPress"-it

PRISHTINË, 29 NËNTOR - "Epoka e re", pas fitores në xhiron e kaluar në derbin ndaj "Klan Kosovës" me rezultat 7-1, do të luajë për fitore edhe në ndeshjen e radhës në Media Ligë ndaj ekipit të "KosovaPress"-it. Nëntë fitore nga njëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara e bëjnë "Epokën e re" favorite edhe në ndeshjen e radhës që zhvillohet sonte (e

premtë) nga ora 21:15. Pesë pikë është diferenca e "Epokës së re" dhe dy skuadrave përcjellëse "Gazetës Metro" dhe "Klan Kosovës". Derbi i kësaj xhiro zhvillohet në mes të "Media Works"-it dhe "Klan Kosovës", këta të fundit do të përpiqen t'u rikthehen fitoreve në mënyrë që të mbesin në hap me ekipin e parë në renditjen tabelore. Për

fitore do të luajë edhe "Media Works"-i, kurse një tjetër derbi është edhe përballja në mes të "Telegrafit" dhe "Gazetës Metro". "Gazeta Zëri" këtë xhiro luan ndaj "RTK"-së, kurse përballjet e tjera janë: "InfoKosova & PrishtinaPost"- "D+", "Infokusi"- "Kallxo.com", "Ora Info"- "Lajmi.net" dhe "Gazeta Blic"- "RTV Dukagjini".





## Përrurohet fusha në Skenderaj, Veseli premton investime të tjera

Skenderaj, 29 nëntor - Në Skenderaj është përruruar fusha e ndërtuar e futbollit me bari artificial, e cila është bërë me investim të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK). Në përrurimin e kësaj fushe i pran-

ishëm ishte kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i cili ka me këtë rast ka premtuar se do të krijohen kushte për sportistët të cilët do të përgatiten për garat ndërkombëtare. "Në Skenderaj përruram stadiumin ndihmës

të futbollit. 12 të tillë, modernë, po ndërtohen në Kosovë aktualisht. Shteti do t'i përkrahë dhe do t'u krijojë kushte sportistëve tanë, në mënyrë që emri i Kosovës të nderohet në arenat e sportit botëror", ka shkruar

Veseli në "Facebook". Të pranishëm në përrurimin e kësaj fushe ishte edhe kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi.



## 'The Telegraph': Kosova, dy fitore larg Evropianit

LONDËR, 29 NËNTOR - Gazeta britanike "The Telegraph" ia ka kushtuar një artikull rrugëtimit të vështirë të futbollit të Kosovës deri te suksesi në Ligën e Kombeve. "Rëndësia e vitit 2018? Përfaqësuesja e Kosovës mbyll vitin si e pamposhtur dhe ka shansin të kualifikohet në Kampionatin Evropian me rekord golash në Ligën e Kombeve dhe fitoi grupin", shkruan "The Telegraph".

Gazeta britanike ka shkruar edhe për mbushjen e kafeneve të Prishtinës me fansa para ndeshjes të cilën Kosova e fitoi 4-0 ndaj Azerbajxhanit. "Shteti më i ri në Evropë është dy fitore larg Evropianit. Fillimisht luan me Maqedoninë, pastaj Gjeorgjinë ose Bjellorusinë", ka shkruar "The Telegraph". "Telegraph" shkruan edhe për momentin kur Kosova në vitin 2016 po bëhej gati për ta luajtur ndeshjen e parë zyrtare dhe se në përfaqësuesen ishin vetëm 12 lojtarë, ndërsa stadiumi në Prishtinë nuk ishte gati për garat ndërkombëtare. "Tani loja e tyre e bukur ka përkrahës që e quajnë përfaqësuesen 'Brazilit' i Ballkanit", shkruan "The



Telegraph", që flet edhe për përzierjen e sportit dhe politikës në Kosovë. "Në mëngjesin e ditës së ndeshjes, Kosova dështoi të anëtarësohej në Interpol, që paraqet vështirësi për njohje ndërkombëtare. Por, kjo nuk i ndali fansat që t'i festonin frytet e dy dekadave rindërtim dhe suksesit të përfaqësueses që drejtohet nga zvicëriani Bernard Challandes", shkruan "The Telegraph". "Në mbrëmje politika nuk mund ta ndalte suksesin e shtetit tonë", ka thënë Arnolld Korenica për gazetën britanike, edhe pse politikanët që dështuan për Interpol u ngutën të shkonin në stadium për ta cilë-

suar fitoren si të tyren. "Xherdan Shaqiri, Granit Xhaka dhe Valon Behrami ishin në gjeneratën e lindur shumë herët për ta përfaqësuar Kosovën, por Arbër Zeneli i Heerenveenit, Milot Rashica i Werder Bremenit dhe portieri i Manchester Cityt, Arjanet Muriqi, janë yjet potencialë që luajnë për Kosovën", kujton "Telegraph" në artikullin e shkruar nga Daniel Zeqiri që tregon se përfaqësuesja e Kosovës nuk kishte asnjë lojtar më të vjetër se 30 vjet. "Kjo reflekton popullatën e këtij vendi që ka moshën mesatare 27.8, më të rejtën në Evropë", shkruan "The Telegraph".

## Dallasi fiton derbin ndaj Houstonit, Minnesota e fortë për San Antonion

DALLAS, 29 NËNTOR - Dallas Mavericks ka vazhduar serinë e rezultateve pozitive, duke mposhtur në derbin teksan Houston Rockets me rezultatin 128-108. Pavarësisht një paraqitjeje fenomenale nga James Harden, i cili realizoi një triple-double, me 25 pikë, 11 rebounde dhe 17 asistime, Rocketsi zhgënjëu përsëri, duke marrë humbjen e 11-të në 20 ndeshje. Për Mavs-in, shkëlqeu i zakonshmi Luka Donçiq, me 20 pikë dhe 6 topa në tabelë. Edhe Milwaukee Bucks ka marrë suksesin e radhës, duke mposhtur me vështirësi 116-113 Chicago Bulls-in. Giannis Antetokoumpo udhëhoqi të tjtë me 36 pikë, 11 topa në tabelë dhe 8 asistime, ndërkohë tek Chicago më të mirët ishin Zach LaVine dhe Jabari Parker, me të dy lojtarët që shënuan nga 24 pikë secili. Dominimi i Minnesota Timberwolves ndaj San Antonio Spurs-it, me rezultatin final i cili u mbyll 89-128. Pas largimit të



Jimmy Butlerit dhe ardhjes së Dario Saric e Robert Covington, Minnesota duket se ka ndryshuar krejtësisht fytyrë. Ishte pikërisht Covington lojtari më i mirë për Timberwolvesin në këtë takim, me 21 pikë dhe 9 topa në tabelë. Tek Spursi, DeMar DeRozan dhe LaMarcus Aldrige nuk ishin në formën e tyre më të mirë, ku e mbyllën sfidën me nga 10 pikë secili. Fitore edhe për Portland

Trail Blazersin kundër Orlando Magicut, me Damian Lillardin i cili dukej në ditën e tij më të mirë. Organizatori i Portlandit theu rekordin e skuadrës për sa iu përket trepikëshave në një ndeshje, duke shënuar gjithsej 10 të tillë, dhe duke e mbyllur sfidën me 41 pikë dhe 8 rebounde. Për Magicun shkëlqeu malazezi Nikola Vuçević me 20 pikë, 8 topa në tabelë dhe 7 asistime.

### SHKURT

#### U19-shat në futboll grumbullohen më 4 dhjetor

